# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7370 E premte 1 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)









Opinioni i Ditës

Nga ARIAN GALDINI

## Për flamurin e 1 kombi dhe 2 qeveritë e tij



Nuk është e vërtetë se kombi shqiptar ka 2 qeveri. Janë në fakt 5, qeveritë që kanë punë me shqiptarët. Çdo nënvleftësim apo mospërfillje e kësaj të vërtete ...

Vijon në faqen 20



Dje në "Deutsche Welle"

Nga ZORAN ARBUTINA

## Fund vdekjeprurës dhe fije shprese

Përfundimi i gjyqit për krime lufte në Hagë qe i pazakontë: pak pas konfirmimit të vendimit me 20 vjet heqje lirie edhe prej gjykatës së shkallës së dytë, ....

Vijon në faqen 21



Kuvend, Buxheti miratohet me 73 vota

## Basha i kërkon dorëheqjen, Rama: Mbetjet? Iki nëse janë 400 mln euro

Arben Ahmetaj: Do të vazhdojmë të ulim taksat. Bien amendamentet e PD. LSI: Punësime imagjinare

Nga VALENTINA MADANI

Kryeministri Edi Rama dhe kreu i opozitës Lulzim Basha shkëmbyen dje në Kuvend replika të forta teksa diskutohej projektbuxheti 2018, por krimi dhe droga përfshinë palët në debate të ashpra. Z.Basha akuzoi se operacioni ...

Në faqen 4

RESHJET E DENDURA, BLLOKOHET AUTOSTRADA TIRANE-DURRES, NDERHYN USHTRIA

# PERMBYTJET, SHQIPERIA NEN UJE DHE NE ERRESIRE

Uji arrin në lartësinë 1.5 metra në Kamëz, bllokohen 40 vetë. Ndërpritet puna në porte. Ja 4 qytetet më të rrezikuara sot dhe nesër



*(Në foto)* Përmbytje në Tirane. Zjarrëfikësit dhe Forcat e Armatosura duke ndihmuar qytetarët

Në faqet 2-3

SHTETI JOSOCIAL

## Rritet pabarazia, INSTAT: 93% e shqiptarëve jetuan me 4 euro në ditë

Në faqen 10

INTERVISTA

## Mevlan Shanaj dhe Natasha Lako: Një film për ata që na kthyen shpinën

Në faqet 18-19

KRYETARI I KQZ

## Shkarkimi i Zgurit, PS tërheq kërkesën, Rama: Dialog me opozitën

Në faqen 7

DOKUMENTACIONI

## "Mësues për Shqipërinë" nis aplikimet, si do zgjidhen fituesit

Në faqen 11

BATUTAT NE SEANCE



## Berisha rrëfen takimin me Ramën në vitin '91: Më the "var komunistët"

Në faqen 5

Shpërthimi te Unaza e Re në Tiranë, policia: Dyshime për konkurrencën

## Tritol në makinë biznesmenit të inerteve

*Dëshmia e Ndok Rajtës: Nuk e di kush janë autorët, nuk kam konflikte*

Nga INA ALLKANJARI

Një automjet u shkatërrua plotësisht mëngjesin e dje-shëm në Tiranë, nga aktivizimi i një sasie eksplozivi. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 09:45, në rrugën dytësore të Unazës së Re, pranë Liqenit të Thatë. Mësohet se fuqia



shpërthyese ka qenë shumë e madhe, por nuk ka persona të lënduar pasi automjeti në momentin e shpërthimit ka qenë në parkim. Bëhet fjalë për automjetin tip "Volswagen" me targë AA 946 EE, në pronësi të të shtetasit Ndok Rajta. Bëhet me dije se 42-vjeçari ...

Në faqen 8

# STUHIA E RESHJEVE
## PERMBYTJET

Përmbytje në Vlorë, evakuohen 3 familje. Tej fryhet lumi Zezë, panik në Fushë-Krujë

# "Çmendet" moti, zhyten nën ujë dhe errësirë disa zona të vendit

## Kiri del nga shtrati, rrezikojnë 2 banorë në Shkodër


Përmbytjet e djeshme në Tiranë

Stuhia e shirave ka shkaktuar përmbytje në disa rrethe të vendit. Situata paraqitet më shumë problematike në qarkun e Shkodrës dhe atë të Vlorës. Për shkak të prurjeve të shumta, lumi Kir në Shkodër ka dalë nga shtrati dhe ka rrezikuar jetën e dy banorëve. Në ndihmë të tyre kanë shkruar forcat e FNSH-së dhe të policisë, të cilët kanë mundur t'i shpëtojnë. Ndërkohë në fshatin Risili të Vlorës janë evakuuar tri familje, të cilave u janë përmbytur banesat. Rreziku nga përmbytjet, ka bërë që Emergjencat Civile në Elbasan, Fier dhe Korçë të marrin masa.Burime zyrtare nga OSHEE dje bënë me dije se si pasojë stuhisë ka patur ndërprerje të energjisë elektrike në rrethet: Kukës, Burrel, Shkodër, Shijak, Berat, Fier, Gramsh, Vlorë dhe Korçë.

**SHKODËR**

Përkeqësimi i motit ka krijuar probleme në zonën e Shkodrës. Mësohet se nga vërshimi i ujërave janë përmbytur rreth 90 ha tokë, ku rreth 50 ha në zonën "Ana e Malit" dhe 40 hektarë në zonën fushore të fshatit Rrenc. Përmbytje janë shënuar në segmentin rrugor Shkodër-Velipojë dhe Shkodër-Mjedë. Ndërsa, lumi Kir ka rritur në mënyrë të frikshme prurjet. Mësohet se si pasojë e stuhisë së reshjeve ka pasur mungesë energjie në fshatrat e Njësisë Administrative Rrethina dhe Postribë. Edhe në Bërdicë mungon energjia elektrike në gjithë fshatrat. Ndërsa, në zonën e Gurit të Zi ka pasur disa herë ndërprerje të vogla të energjisë elektrike, por që është rikthyer pas pak minutash. Gjithashtu, energjia elektrike mungon edhe në Velipojë dhe për rrjedhojë dy hidrovorët nuk janë në punë.

**VLORË**

Reshjet e shiut kanë shkaktuar përmbytje në Vlorë. Tri familje janë evakuuar në fshatin Risili për shkak të prurjeve të mëdha të lumit Shushicë. Familjet që janë evakuuar rrezikoheshin që të prekeshin nga prurjet e lumit, prandaj janë zhvendosur nga Emergjencat Civile. Ndërsa, pritet që në vijim të evakuohen familje të tjera. Në orët në vijim pritet që të evakuohen familje të tjera. Moti i keq, me erëra të forta dhe reshje të dendura shiu, ka lënë pa energji zonat e Orikumit, Tragjasit dhe Radhimës. Rreziku nga përmbytjet ka alarmuar banorët e Vlorës, të cilët janë angazhuar dhe kanë nisur të marrin masat e para. Vendosja e thasëve me rërë si barrierë përpara dyerve të bizneseve dhe banesave, është mënyra që banorët kanë zgjedhur për të parandaluar sadopak rrezikun që iu kanoset nga përmbytjet. Nevojë emergjente, sipas banorëve, mbetet pastrimi i kanalizimeve, pasi është shkaktari kryesor i përmbytjeve të shpeshta vitet e shkuara.


Përmbytjet e djeshme në Shkodër

**RRETHET E TJERA**

Prefekti i qarkut Elbasan, Maksim Malaj dhe Emergjencave Civile pranë këtij qarku, gjatë paradites së djeshme kanë inspektuar të gjitha zonat me risk nga fatkeqësitë natyrore. Prefekti Malaj ka inspektuar në terren rrjedhën e përrenjve Zaranikë e Manazderen, që në mot me reshje janë rrezik potencial për përmbytjen e lagjeve periferike të qytetit të Elbasanit. Po kështu ka inspektuar situatën që paraqitet në fshatrat problematikë përgjatë rrjedhës së Shkumbinit. Për të shmangur rrezikun e përmbytjeve të dy viteve më parë, në Fier është hartuar një plan i detajuar. Në mbledhjen e Shtabit të Emergjencave Civile, kreu i Bashkisë zbuloi planin e masave duke u përqendruar në zonat me kritike që mund të preken nga vërshimet e ujit. Katër hidrovorët janë në gatishmëri të plotë dhe kanë edhe burime alternative energjie, edhe në rast se kjo e fundit do të shkëputet. Ndërsa, në Korçë, grupet e punës janë nën monitorim të vazhdueshëm të pikave më kritike që rrezikohen nga përmbytjet si fusha e Maliqit, lumi i Vërdovës në Pogradec, dhe lumi në hyrje të qytetit të Ersekës.

**FUSHË-KRUJË**

Situatë problematike është krijuar nga reshjet e shiut edhe në Fushë-Krujë, ku lumi Zezë është fryrë tej mase nga prurjet. Banorët janë përfshirë nga paniku, pasi lumi rrezikon të dalë nga shtrati dhe rrezikon përmbytjen e dy lagjeve të këtij qyteti.

**BULQIZË**

Reshjet e dendura të shiut kanë shkaktuar probleme edhe në zonën e Bulqizës. Një grumbull kromi ka rrëshqitur pasditen e djeshme, duke rënë mbi tubacionin e ujit të pijshëm, duke rrezikuar prishjen e tij. Nga rrëshqitja e stogut të kromit është dëmtuar edhe godina pranë minierës së zonës. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar punonjësit e Ujësjellësit, por ata pohuan se "ndërhyrja është e pamundur, pasi ka rrezikshmëri të lartë".

## Shpërthen automati, plagosen 3 punonjës të OSHEE-së në Shkodër

Tre punonjës të OSHEE janë plagosur pasditen e djeshme në Shkodër. Bëhet fjalë për shtetasit Erjon Hafizi, Agron Berisha dhe Afrim Halluni. Mësohet se 3 operatorët po punonin për të riparuar një defekt në nënstacionin "Shkodra 1", por papritur një valë elektriciteti (ka shpërthyer automati) u ka shkaktuar atyre djegie në trup. Fillimisht ata janë dërguar në spitalin e qytetit verior dhe më pas, për shkak të situatës serioze, janë nisur drejt Tiranës për trajtim të specializuar.

## Reshjet e dendura të shiut, disa zona rurale të qarkut të Gjirokastrës 14 orë pa drita

**GJIROKASTËR** - Reshjet e dendura të shiut dhe rreziku i përmbytjeve kanë krijuar situatë emergjente në qarkun e Gjirokastrës. Mësohet se disa fshatra të këtij qarku kanë mbi 13-14 orë pa energji elektrike për shkak të defekteve në rrjetin e furnizimit, i cili është amortizuar dhe nuk është rikonstruktuar prej shumë vitesh. Probleme ka pasur në zonën e Përmetit, Këlcyrës, Zagorisë, në disa fshatra të Tepelenës dhe Gjirokastrës. Nisur nga situata e krijuar, prefekti Astrit Alia kërkoi marrjen urgjente të masave, si dhe ndërprerjen e procesit mësimor në shkollat rurale. Situata është problematike në Tepelenë, ku lagjja e poshtme e saj rrezikon përmbytje. Zonat të rrezikuara mbeten edhe pjesa verilindore e Memaliajt, si edhe fushat e Qesaratit, Krasit e Kalivaçit. Rrëshqitje dheu ka pasur në zonën e Përmetit, në Çarçovë, dhe Frashër si dhe në aksin rrugor Jorgucat-Muzinë. "Për shkak të kushteve të rënduara të motit mësimi i ditës së nesërme (datë 1 dhjetor) do të realizohet një ditë të shtunë", - ka njoftuar DAR Gjirokastër.





## Shemsi Premçi: Qytetet më të rrezikuara nga reshjet: Vlora, Fieri, Gjirokastra e Korça

**TIRANË** - Drejtori i përgjithshëm i Emergjencave Civile, Shemsi Premçi, duke bërë një tablo të situatës së motit të keq ka deklaruar se aktualisht në vend bien reshje mesatare, por ato pritet të intensifikohen në ditët e ardhshme dhe do të shkaktojnë probleme kryesisht në jug të vendit. "Shërbimet meteorologjike vendase dhe të huaja kanë dhënë informacion të detajuar mbi situatën e pritshme, kryesisht për zonën jug-perëndimore. Në vijim të natës së sotme dhe datës 1 dhjetor do të ketë mbi 110 milimetra reshje nga 35 mm që kanë qenë në 24 orët e kaluara",-ka deklaruar Premçi. Duke folur për "Report TV", zyrtari i lartë ka paralajmëruar se, rrjedhimisht do të ketë edhe prurje të lumenjve të vendit, nga të cilët Semani dhe Vjosa pritet të kenë më të mëdhatë. Sipas kreut të Emergjencave Civile, se qytetet më të rrezikuara do të jenë Vlora, Fieri, Gjirokastra dhe Korça.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



### Kapiteneria e Përgjithshme: Po monitorojmë situatën

# Stuhia e reshjeve, pezullohet aktiviteti në portet e Durrësit, Vlorës dhe Sarandës

Moti i keq që ka përfshirë vendin tonë ka bërë që të pezullohet aktiviteti në porte. Për shkak të stuhisë së shirave, në Durrës, Kapiteneria e Portit të Durrësit ka urdhëruar pezullimin e anijeve të tonazhit të ulët e të mesëm, si dhe pezullimin deri në një urdhër të dytë të të gjithë sektorit të peshkimit në vend. Sipas Kapitenerisë së Përgjithshme, deti është shumë i trazuar dhe dallgët arrijnë deri në 6 ballë në gji, ndërsa në det të hapur deri në 8 ballë. Kapitaneria bën me dije se janë marrë masa dhe po monitorohet situata. Parashikohet përkeqësim i motit në orët në vazhdim, ndërsa tragetet e linjës Durrës-Bari, Durrës-Ankona pritet të mbërrijnë me 6-9 orë vonesë. Dje është paralizua lëvizja e trageteve të linjës Sarandë-Korfuz dhe anasjelltas për shkak të situatës së rënduar nga moti i keq, me reshje me intensitet dhe erë të fortë, ku valëzimi në det shkon 5-6 ballë në drejtimin juglindje. Sipas Kapitenerisë së Portit në Sarandë bëhet me dije se në tre ditët e ardhshme pritet të mos ketë lëvizje të tragetit në itinerarin Sarandë-Korfuz dhe anasjelltas. Edhe në Vlorë vijon të jetë i pezulluar lundrimi në det të hapur për të gjitha mjetet. Kapiteneria e Vlorës njoftoi se për shkak të motit të keq do të bllokohet për dy ditë lundrimi i trageteve të linjës Vlorë-Brindisi.




**URDHËRI I RAMËS**

Në përfundim të seancës parlamentare, kreu i Kuvendit, Ruçi lajmëroi deputetët e PS-së se me kërkesë të kreut të Grupit Parlamentar duhet të qëndronin në sallë. Kryeministri njëherësh edhe kryetar i PS-së, Edi Rama u ka kërkuar të gjithë deputetëve të jenë pranë zonave dhe elektoratit të tyre për t'u ardhur sa më parë në ndihmë. Rama u kërkoi deputetëve të dalin të gjithë në terren për të parë situatën e përmbytjeve.

Uji arrin në 1.5 m në Kamëz, bllokohen rreth 40 persona në total. Jashtë funksionit nënstacioni i Kasharit

# Rebeshi i shirave "mposht" kryeqytetin

## *Përmbytet autostrada Tiranë-Durrës, ndërhyn ushtria*

Voltiza Duro

Reshjet e dendura që kanë përfshirë vendin gjatë 24 orëve të fundit, kanë shkaktuar panik e problematika të shumta edhe në qarkun e Tiranës. Autostrada Tiranë-Durrës është bllokuar pasditen e djeshme, në afërsi të kilometrit të gjashtë, si pasojë e përmbytjeve nga shiu. Niveli i ujit ka arritur rreth 1 metër në karrexhatë, çka e bërë të pamundur qarkullimin e automjeteve e madje shumë banorë të zonës kanë mbetur të izoluar. Ka pasur edhe raste kur një qytetar, ka zgjedhur gomonen si mjetin e vetëm për t'i ardhur në ndihmë familjarëve të bllokuar nga uji. Në këtë situatë emergjente, është dashur ndërhyrja e Forcave të Armatosura ku tre motopompa të komandës mbështetëse kanë mbërritur në afërsi të kthesës së Rinasit për largimin e ujit. Policia Rrugore ka marrë masa duke devijuar qarkullimin e mjeteve në rrugën dytësore përballë me karburantin. Pas përmbytjes, autostrada është përballur edhe me ndërprerjen e energjisë elektrike, çka ka shkaktuar një errësirë totale, duke e bërë lëvizjen në këtë aks tepër të rrezikshme. Ndërkaq, në orët e vona të mbrëmjes së ditës së djeshme, në Kamëz, niveli i ujit ka arritur në 1.5 metër e si pasojë kanë mbetur të bllokuar 13 qytetarë, mes të cilëve edhe 4 fëmijë. Ndërkohë situata e vështirë është paraqitur edhe në Valias, ku plot 10 persona kanë mbetur të bllokuar mes ujit për orë të tëra duke pritur ndërhyrjen e ushtrisë për evakuim. Mes të bllokuarve, në 10 banesa ndodheshin edhe 4 fëmijë dhe 3 punonjës të zjarrfikëses. Në vendngjarje ka mbërritur edhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Bardhyl Kollçaku. Gjithashtu, edhe nënstacioni i Kasharit është përmbytur duke lënë pa energji Kamzën, Laprakën e Kombinatin. Ndërkaq, në autostradë janë përmbytur edhe disa banesa e biznese. Reshjet e dendura kanë krijuar një situatë të rënduar edhe në Laknas ku 3 banesa janë përmbytur e është dashur ndërhyrja e Emergjencave Civile për të evakuuar banorët. Por shiu i furishëm nuk ka kursyer dhe urgjencën e QSUT-së dhe ambientet e komisariatit nr. 5 në kryeqytet. Por, OSHEE ka raportuar edhe një sërë problemesh edhe me energjinë elektrike në rajonin e Tiranës, e për pasojë zonat e Mulletit, Pezës, Zall Bastarit e Ibë-s kanë mbetur në terr. Ndërkohë rreth 600 punonjës të OSHEE kanë dalë në terren për të minimizuar defektet. Shërbimet e Policisë Rrugore dhe ato të rendit i kanë bërë thirrje qytetarëve që të telefonojnë numrin 112 për çdo situatë emergjente e ka kërkuar mirëkuptimin e drejtuesve të mjeteve si dhe rritjen e kujdesit në rrugë gjatë drejtimit të automjetit.

**OLTA XHAÇKA**

Në lidhje me situatën e krijuar nga reshjet ka reaguar edhe ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka. "Janë porositur të gjithë prefektët e qarqeve, drejtuesit e bashkive për marrjen e masave urgjente për përballimin e çdo situate emergjente për garantimin e jetesës normale të komunitetit.",-deklaroi ministrja.


Përmbytjet në Tiranë

### GOMONE NË AUTOSTRADË

Një qytetar, ka zgjedhur gomonen si mjetin e vetëm për t'i ardhur në ndihmë familjarëve të bllokuar nga uji. Niveli i ujit ka arritur rreth 1 metër në karrexhatë, çka ka bërë të pamundur qarkullimin e automjeteve e madje shumë banorë të zonës kanë mbetur të izoluar.

### Pezullohet procesi mësimor para universitar në vend

Reshjet e dendura të shiut dhe përkeqësimi i motit, kanë bërë që Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë të pezullojë procesin mësimor në arsimin parauniversitar në mbarë vendin ditën e sotme. "Sipas Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), por edhe nga shërbimet meteorologjike që bashkëpunojnë me Emergjencat Civile, informohemi paraprakisht se moti në të gjithë territorin e vendit gjatë datës 1 dhjetor 2017, është të drejt përkeqësimit, pasi priten reshje të dendura shiu. Për sa më sipër, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë njofton pezullimin e procesit mësimor, në datën 1 dhjetor 2017, në të gjitha institucionet arsimore të arsimit para universitar."-thuhet në njoftimin zyrtar të ministrisë. Ndërkaq kjo e fundit bën me dije se dita e humbur e procesit mësimor do të zëvendësohet një ditë tjetër.

## PARLAMENTI
## DEBATET

"Forca e ligjit", akuzat e opozitës për lidhjet e pushtetarëve me krimin

# Basha i kërkon dorëheqjen, Rama: Iki për 400 milionë euro

## *Kreu i PD i bën llogaritë nga foltorja*



Valentina Madani

Kryeministri Edi Rama dhe kreu i opozitës Lulzim Basha shkëmbyen dje në Kuvend replika të forta teksa diskutohej projektbuxheti 2018, por krimi dhe droga përfshinë palët në debate të ashpra. Z.Basha akuzoi se operacioni "Forca e ligjit" është qesharak dhe se nuk ka dhënë asnjë rezultat. Sipas tij, Rama dhe Xhafaj nuk mund ta luftojnë krimin, dhe se në Vlorë ku kryeministri është deputet dhe ministri ka origjinën, vijon lufta mes bandave me kallash e dinamit. Z.Rama i bëri një sfidë të hapur kryetarit të PD-së Lulzim Basha sa i takon akuzave për projektin me impiantin e mbetjeve. Ky i fundit pohoi se projekti parashikon një shifër prej 4 milionë eurosh. Por ky fakt u rrëzua nga Rama, i cili tha se ishte i gatshëm të jepte dorëheqjen nga posti nëse vërtetohej ky fakt. Basha, i cili nisi të bënte llogaritë live i rezultoi se nuk ishin 400 milionë, por 350 milionë. "Rama dhe Xhafaj nuk mund të luftojnë krimin. Rezultatet e operacionit "Forca e ligjit" janë qesharake. Janë arrestuar disa gra të akuzuara për prostitucion. Policia është e ritahirizuar, duke zëvendësuar luftën ndaj krimit me teatër. Ngjarja më e madhe ishte dhënia e çmimeve policisë për shërbimin. Policët përdoren, abuzohen për të bërë videoklipe në Vlorë, ku Rama është deputet, ku Xhafaj ka origjinën, bëhet luftë mes bandave me kallash e dinamit. Vetëm sot pasiguria ka marrë formën tragjike të shpërthimeve të automjeteve në Tiranë. Droga e krimi nuk kanë mbaruar, shteti dhe qeverisja e Ramës kanë mbaruar. Ky është realiteti, këto janë faktet, kjo është e vërteta, gjendja është dramatike. Rama vazhdon t'i shmanget çdo lloj përgjegjësie, 20 vjet në politikë, vazhdon e drejton gishtin nga politika, sepse është i papërgjegjshëm. Si piktor, Ramës të gjitha ngjyrat i duken të zeza, ndaj ka shtruar ushtrinë e Habilajve, Balilëve, Dakove, duke sulmuar e nxirë gjithçka",-tha z.Basha. Kryeministri Edi Rama iu përgjigj akuzave të opozitës për pastrim parash lidhur me projektin e investimeve 1 miliard dollarë. Rama solli sërish në vëmendje emrat e ndërtuesve që kanë marrë tenderë për ndërtimin e rrugëve, ndërsa për herë të parë zbuloi emrin e biznesmenit Rrok Gjoka që ka marrë me koncesion ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Sipas Ramës, Gjoka është financues i PD-së dhe ka marrë tenderë edhe nga Lulzim Basha në Bashkinë e Tiranës.

**SFIDA**

Z.Rama i bëri një sfidë të hapur z.Basha për projektin me impiantin e mbetjeve. Basha pohoi se projekti parashikon një shifër 4 mil euro. Por ky fakt u rrëzua nga Rama, i cili tha se ishte i gatshëm të jepte dorëheqjen nga posti nëse vërtetohej ky fakt. Basha, i cili nisi të bënte llogaritë live, i rezultoi se nuk ishin 400 milionë, por 350 milionë.



**AKUZA**

Deputetja e PD Albana Vokshi deklaroi dje në Kuvend se Rama i urren gratë: "Është e papranueshme gjuha fyese dhe përçmuese që ju përdorni ndaj grave deputete dhe ndaj çdo gruaje që ju rri përballë dhe mendon ndryshe". Por Rama iu përgjigj: "Albanën e kemi për kullën e vrojtimit, Lulzim, për aeroportin e Vlorës, kurse atij i takon biletë çift për "Air Albania" se ka udhëtuar shumë me "BelleAir".

### DEBATET RAMA-BASHA, NGA INCIDENTI ME TATIMORËT DERI TE LODRAT

- **Lulzim Basha:** Këto ditë qeveria ka vendosur të japë 2.5 mln euro për zëvendësimin e palmave me pisha. Janë 8 mln euro të grabitura dhe shpërdoruara nga Rama dhe njerëzit e tij. Ato do shërbenin për të paguar një rrogë normale për familjet e Bulqizës, që fëmijët e tyre rropaten për bukën e gojës. Këtë e bën vetëm një qeveri dhe një kryeministër që i ka vënë shkelmin vendit të vet. E pamë sa pak dinjitet dhe respekt kanë për veten gratë dhe burrat e kësaj qeverie, që bënin sikur kositnin barin në Lushnje, duke u sjellë si lolo.
- **Edi Rama:** Kë rrugë mbaruat ju, Rrugën e Kombit që do 150 mln euro. Rrugën e Arbrit? Flisni për pastrim parash me rrugët, me ndërtimin e rrugëve. Rrok Gjokën e njihni? Ju të Republikës së Re mos shihni, se nuk e njihni, e kam me këta të Republikës së Vjetër. Ai është themeltar i PD. Sponsor i PD në çdo fushatë elektorale. Është përfitues i tenderëve të kryetarit aktual të PD kur ishte kryetar i Bashkisë së Tiranës. Ato para po pastron? Rrok Gjoka do i pastrojë paratë? Paratë e kujt, paratë e lumit që nuk iu merr juve dhe t'ju nxjerrë të larë. Paratë e pikës që s'u bie që merreni me këto lloj gjërash. Rrugën tjetër, për në drejtim të Thumanës, po e ndërton Bashkim Ulaj. Kush është Lulëzim, më shih në sy, kush është Bashkim Ulaj? Projekti 1 mld do bëhet, doni apo nuk doni ju. Puna juaj është kjo, eja këtu, bëj muhabet këtu, shih orën që s'mbaron, dil mbrapa, këta jeni ju, jeni të marrë fund. Bashkim Ulaj, njeriu që rindërtoi SHQUP-in dhe ta bëri ty gati.
- **Lulzim Basha:** Kam një eksperience personale me tatimorët në një lokal në periferi të Tiranës. Mënyra se si u sollën ishte skandaloze, nisën të numëronin faturat dhe pjatat e çdo klienti. Klientët u shqetësuan, pronarët, gjithashtu. Pasi u larguan, e zonja e lokalit mu afrua dhe më tha se për tre muaj ka marrë disa gjoba milionëshe. Është abuzim i madh ky i tatimorëve.
- **Edi Rama:** Si ka mundësi që restoranti ishte plot, mo Lulzim. Me këtë qamet që përshkruani ju, si ka mundësi që restoranti ishte plot. Ta them unë, sepse konsumi vazhdon të rritet, fuqia blerëse vazhdon e rritet. Prandaj dhe restoranti ku shkove e bleve ishte plot, shko prapë se plot do e gjesh. Sa për gjobat, do vazhdojnë të vihen për këdo që nuk zbaton ligjin. I mësuat ju dhe e bëtë shtetin lesh e li. Ne do ta ngremë gjithçka nga e para, kudo.
- **Edi Rama:** Lulzim hajde merr fjalën këtu dhe bëhu serioz se je kryetar i PD. Duam s'duam ne, ty lodrën ta fali Saliu. Po ti nuk ja di kuptimin dhe vlerën kësaj lodre po taksirat i Dash Shehit dhe Florjon Mimës thuaj që të rregullojnë lodrën kur prishet. Kur ju thosha se do vijë FBI nuk më besonit. Pa merak se do kapen peshqit e mëdhenj, por lutuni mos ju kapë zgara.
- **Lulzim Basha:** Pse përdor fjalor horri me opozitën?! Ti flet këtu dhe peshqit po prishin gardhin. Peshqit janë kapur, po presin të dalë peshkarexha në breg. Që në 2005 ke qenë në sistem (Rama). Ai ka qenë kryebashkiak bashkie, dhe deri në 2011 i la shenjat e veta në Tiranë, shihni te Komuna e Parisit. Një gropë ia mbulova unë. Tani vjen dhe përmend emrat e biznesmenëve dhe thotë se janë themelues të PD dhe sponsor të PD. Por janë gënjeshtra. Si nuk fole për Habilajt, ti?! Nëse pastrojnë paratë e drogës duhet të negociojnë për avokat. Basha s'ka bërë kurrë pakte me oligarkët. Tenderët i bëje ti. Unë kam kursyer 6 për qind të tenderëve. Javën e kaluar gjermanët ta kujtuan dhe shprehën habinë se si mund të kalosh ti nga A tek XH. Në mendjen e tyre nuk është thjesht çështja e fazave që duhet të kalojë trajtimi i mbetjeve në vend. Merri dokumentet e qeverisë tende dhe shikoji. Dhe më thuaj pse tre inceneratorët kanë të njëjtin pronar. Me të tjerat je bërë bajat. Ti nuk fshihesh dot as pas Skifterit, as pas Habiljave, as Balilit.
- **Edi Rama:** Jam nxënës i Konicës dhe Nolit, pjesë e kësaj shkolle është gjuha sarkastike, shkolla më e lartë e oratorisë, por unë as dje dhe as sot e nesër s'do t'i them kundërshtarit horr dhe klloun. Ato ishin dy fjalë që i përdori kryetari i opozitës. I shpreh keqardhje, le të vazhdojë kështu, këto janë fyerje dhe sarkazma të dhemb më shumë se këto fjalët e rrugës, por për këtë punë është bërë. Lulzim ke dy rrugë, ose ktheje dhimbjen në forcë dhe drejtoju për ndihmë Faikut dhe priftit të madh, ose vazhdo me gjuhën e rrugës, horr, kloun e kriminel që janë pjesë e një fjalori që në atë shkollë quhet fjalor ngalësish në oratori me standardet e shkollës që bëj unë, ose kthe dhimbjen në forcë, ose vazhdo me rrugën e gjuhës që duken si ngelës. Je ngelës, Lulzim. Ju jeni 'gdhë' gdhë'. Nëse janë 400 milionë euro për impiantet e përpunimit dhe trajtimit të mbetjeve, unë jap dorëheqje. Ti e jep dorëheqjen? Çoje kokën dhe më shiko! E ke Saliun aty dhe thotë do dal. Nëse janë 400 milionë euro, unë jap dorëheqje.
- **Lulzim Basha:** Ja ku e ke këtu, 228 milionë është totali i tre kontratave. Për këto zotrote, ke planifikuar këtu: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Tiranës, kohëzgjatja 7 vjet 2015-2022, kosto vjetore 752 e 770, pra 7 vjet nga 7 milion, pra euro, dakord po e marrim dollarë. 7 herë 7 bëjnë 42, më fal 49 se pashë gjashtën. Ndërtimi, operimi, transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Fierit: 6 herë gjashtë 36, 49 plus 36 bëjnë 95, bëjnë 85 s'ka rëndësi. U shkritë ju u shkritë se për ju janë patate këto. 85 milionë i ke te këto të dyja. 2018-2047 1 miliard lekë të reja, 10 milionë po t'i marr, herë 30 bëjnë 300. Të kërkoj ndjese se s'qenkan 400, por 385 milionë dollarë, jo euro, po të ul dhe kursin e këmbimit, pra janë 350 milionë. Do zhvatësh 50 milionë më pak, të kërkoj ndjesë që të akuzova që po bëhesh gati që me një kompani të vetme, me një person bën tre projekte dhe ju merr 350 milionë euro dhe jo 400 milionë euro shqiptarëve.
- **Edi Rama:** Mos e merr më fjalën për sot



### Salianji-Ramës: Edhe Perëndinë e dini që blihet me para?

Deputeti i PD-së Ervin Salianji e krahasoi kryeministrin Rama me personazh filmi. "Për 5 orë kryeministri që duhet të japë llogari për buxhetin u mor nga fillimi në fund as me opozitën, por duke bërë estradë si Xha Lipja te filmi "Kur zbardhi një ditë", që rrinte gjithë kohën aty në një cep dhe thoshte po unë s'kam materiale, kjo punë nuk bëhet. Asnjë nga deputetët e mazhorancës nuk foli as për rendin e ditës, as për situatën dhe gjëmën e madhe që i ka ndodhur këtij vendi jo vetëm me kanabizimin por me varfërinë, shkretimin, me largimin e qytetarëve nga ky vend…pjesën më të madhe të parave që do kalojë kjo qeveri me ketë buxhet do ja kalojë një grushti njerëzish apo një grupimi të vogël klientësh të lidhur drejtpërdrejtë me qeverinë. Secili këtu bënte estradaxhiun e madh, dikush tha që kalojini paratë nga rruga e Perëndisë, po pse mo, e dini se edhe Perëndia blihet si gjithçka tjetër?",-tha Salianji.

I kujtoi takimin e 26 viteve më parë në prani të Trebeshinës dhe Klosit

# Berisha rrëfen takimin me Ramën në '91, batutat në Kuvend

## "Kërkove të varen komunistët, po babai yt?"

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha rrëfeu dje në parlament bisedën që ka bërë për herë të parë me Edi Ramën në janar të vitit 1991. Takimi i parë mes tyre u soll në vëmendje nga kryeministri Rama gjatë fjalimit në foltoren e Kuvendit. Ai zbuloi se çfarë i kishte thënë z.Berisha në atë takim, sipas të cilit e kishte akuzuar se do nxirrte llumin nga burgu, duke iu referuar ish-të dënuarve nga regjimi komunist. "Jam takuar me Saliun në janar të vitit 1991. Shoku Sali atëherë, se ishte me teserën e partisë në xhep. Atëherë më tha mua, isha me Kasem Trebeshinën dhe Ardian Klosin, se ju doni të nxirrni llumin nga burgu. Sekretari i Parë i Partisë e ka kthyer PD-në në një karagjozllëk kombëtar. Ju nuk dini të bëni shtet, nuk dini të bëni punë, përveçse të ndërtoni fshatin tuaj të vogël në çdo zyrë. E mori nga Ramizi, ia la Ramizit shoku Ramiz, ia la Ramizit xhunior. Qeshu Sali, qeshu se PD-ja është e jotja. Nuk ju them pse nuk bëtë stadiume, sepse Saliu futbollin e ka luajtur me gurë. Këtu Saliu është i justifikuar. Çfarë t'ju them juve, ju vini këtu me avazin 'droga, droga, droga, krimi, krimi, krimi', duke na e bërë kaq të lehtë fundin e kësaj beteje politike. Tani shoku Ramiz, hajde fol këtu për drogën, për krimin, për narkoshtetin, fillo e merre fjalën", deklaroi z.Rama. Por, ish-kryeministri Berisha deklaroi se kjo nuk ishte biseda e plotë mes të dyve, ndërsa i kujtoi se kishte kërkuar varjen e ish-komunistëve dhe se ai i kishte përmendur babanë e tij. "Fole për një takim të janarit 1991. Është e vërtetë që ke ardhur, që ke ardhur me dy vetë. Më tha se 'unë nuk flas si ti, unë do të them në çdo shtyllë duhet varur një komunist, një anëtar i Byrosë Komuniste'. Thuaje i thashë, po mos harro babanë tënd. E them edhe për atë, më tha", theksoi z.Berisha. Shkak për përplasjen mes Berishës dhe Ramës u bë amendamenti i Partisë Demokratike për ish-të përndjekurit politikë. "Shteti u detyrohet ish- të përndjekurve rreth 32.5 miliardë lekë të reja dhe sipas KLSH-së, duhen 16 vjet për të shlyer detyrimet. Pavarësisht propagandës, gjatë 2009-2013 janë dëmshpërblyer më shumë se gjatë 2014-2017. KLSH thotë se qeveria i ka mundësitë për të rritur fondet. Propozimi i PD është rritje me 2.5 miliardë lekë për vitin 2018", thuhet në amendamentin e PD-së për ish-të përndjekurit politikë. Gjatë seancës së djeshme në Kuvend, ish-kryeministri Sali Berisha përmendi tri emra, që sipas tij janë në krye të trafikut të drogës nga Shqipëria, përveç ish-ministrit Saimir Tahiri. Berisha u shpreh se lajmet nga Greqia bënë me dije se në krye nuk është vetëm Tahiri, por edhe njerëz të afërt të Ramës. Ish-kryeministri përmendi emrin e kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, për të cilin tha se nuk të dhëna, si dhe këshilltarin e Ramës, Engjëll Agaçi dhe vëllain e tij, Olsi Rama. "Dosja italiane nuk e citoi Edi Ramën, jam i sinqertë me gjithë dëshirën që do kisha, por Edi Ramën e denoncoi Edi Rama. Ramën e akuzoi vetë Rama, kur u bë parzmore e atij që u kthye në strumbullar kryesor të krimeve. Për shkak të dosjeve të tij të rënda u dorëzua para Saimir Tahirit dhe i detyroi deputetët e PS të pengojnë drejtësinë, në një akt që s'ka ndodhur kurrë në 27 vite. Lajmet nga Greqia bëjnë me dije se ne krye nuk është vetëm Tahiri, por njerëz të afërt të Edi Ramës. Kush janë këta? Gramoz Ruci? Nuk kam të dhëna për të. I dyti më i afërt është këshilltari i Kryeministrisë Engjëll Agaçi, kumbara që lidh Ndragetën me qeverinë, por nuk kam të dhëna. I treti është Olsi Rama. Klement Balili u shpall Eskobar i Ballkanit se bënte shkëmbimin kanabis-kokainë. Olsi Rama me grupin e tij kriminal në Boston është autori kryesor i kokainës", tha Berisha.





Ish-kryeministri Sali Berisha

**TAKIMI**

"Fole për një takim të janarit 1991. Është e vërtetë që ke ardhur, ke ardhur me dy vetë. Më tha se 'unë nuk flas si ti, unë do të them në çdo shtyllë duhet varur një komunist, një anëtar i Byrosë Komuniste'. Thuaje i thashë, por mos harro babanë tënd. E them edhe për atë, më tha", u shpreh z.Berisha.



### Noka ndërpret Ramën, si e paralajmëron Ruçi

Seanca e djeshme plenare u shoqërua me debate mes palëve. Teksa Rama po fliste në foltoren e Kuvendit, ndërhyri nga salla deputeti i PD, Flamur Noka. Në kundërpërgjigje ndaj tij, Rama nuk e kursye ironinë, ku i ka kërkuar Bashës t'i flasë, duke e quajtur 'shkop'. Irritimi i Nokës erdhi menjëherë pasi Rama tha se nuk mund ta dallonte kryedemokratin nga një parazit që rrinte në kafe e fliste ç'ti tekej. "Kryetari i PD e mori fjalën dhe a ma thoni dot nga çfarë dëgjuat, ku dallonte nga një parazit në kafene, që ka një kafe dhe gotë raki para, i merr temat si t'i vijë në mend, hidhu këtej e dil andej dhe një fjalë nuk e tha për çështjen. Mos më interfero, se më kujton atë zhurmuesin që futej në kanalin e jugosllavit. Lëre për sot, e fitove procesin, ha përshesh aty. Lulzim, foli këtij shkopit, Flamur", deklaroi z.Rama. Por, Noka vijoi të flasë nga vendi duke bërë akuza për koncesionet. Ndërhyn kryeparlamentari Ruçi: "Flamur Noka të lutem, do të të tërheq vëmendjen".

**LOBIMI I PD**

### Prokuroria nis hetimet, Balla: Kallëzim. Basha: Bëje që sot

Prokuroria nisi dje hetimet ndaj PD-së për lobimin e saj me një kompani amerikane gjatë fushatës elektorale. Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, njoftoi dje se ditën e hënë do të bëjnë denoncim në prokurori ndaj Lulzim Bashës në lidhje me pagesat e dyshimta për një kompani lobimi në SHBA. Këtë paralajmërim, Balla e bëri në Kuvend teksa theksoi se kallëzimi në prokurori do të bëhet për mashtrim me financat. Ndërkohë, kreu i PD, Lulzim Basha replikoi duke thënë se akuzat për pastrim parash janë për të hequr vëmendjen nga çështjet aktuale në vend. "Akuzat për pastrim parash nga PD janë furtunë në gotë për t'u ikur të vërtetave për ty, Saimir Tahirin, vëllain e Fatmir Xhafajt. Partia Demokratike ka çuar në KQZ sipas ligjit çdo të ardhur. Nuk ka asgjë për të fshehur PD. Njeriu që fsheh paratë je vetëm ti Edi Rama. Ti je ai që duhet të ishte nën akuzë për pastrim parash. Mos prit të hënën. Çoje sot në prokurori", theksoi kreu i PD-së, Lulzim Basha.



**INCENERATORËT**

### Koka kundër PD-së: Shifrat të fryra, investim me fitim

Ish-ministri i Mjedisit, Lefter Koka, deklaroi dje në Kuvend se investimi në inceneratorët për menaxhimin e mbetjeve është një investim me fitim dhe shifrat e fryra që flasin politikanët nuk u shërbejnë as qytetarëve dhe as menaxhimit të mbetjeve. Sipas tij, inceneratori i Elbasanit dhe energjia e prodhuar aty do t'i shërbejë bashkisë që të bëjë pastrimin e plotë të qytetit. "Shifrat janë keqinformime, nëse nuk mundemi dot të dëgjojmë njëri-tjetrin, nuk e pastrojmë dot vendin dhe investimi në inceneratorët është gjë e mirë. Landfilldi i Vlorës, që nisi kur ishte PD në pushtet ka një kosto prej 25 euro për ton, një vlerë prej 24 mln euro duke falur edhe taksa. Por pas 20 viteve, Vlora do të ketë një fushë 20 ha me një lartësi prej 15 metrash me mbetje dhe kostoja do të ketë shkuar 60 mln. Për sa i përket inceneratorit të Elbasanit, pas 20 viteve ky investim do t'i ketë larë paratë e investimeve dhe do ketë filluar të fitojë 1.8 mln euro. Shifrat që flasin për 400 mln euro janë të fryra dhe nuk i shërbejnë askujt", theksoi z.Koka.



**IRONIA**

"Qeshu Sali, qeshu se PD-ja është e jotja. Nuk ju them pse nuk bëtë stadiume, sepse Saliu futbollin e ka luajtur me gurë. Këtu Saliu është i justifikuar", - tha Rama.

# BUXHETI 2018
## VOTIMI

Deputetët e PD-së shkurtojnë diskutimet për shkak të përmbytjeve

# PS voton me 73 vota Buxhetin 2018, rrëzohen amendamentet e opozitës

## *Arben Ahmetaj: Do vazhdojmë të ulim taksat*



Deputetët e Kuvendit u detyruan të përmbledhin diskutimet për amendamentet e paraqitura nga PD për Buxhetin e vitit 2018 për shkak të rëndesës së situatës nga përmbytjet. Pas kërkesës së ministres së Mbrojtjes, Olta Xhaçka dhe me miratimin e kreut të PD-së, Lulzim Basha, deputetët e PD-së shkurtuan ndërhyrjet për prezantimin e amendamenteve të tyre për buxhetin. Buxheti u miratua dje me 73 vota "pro" të mazhorancës dhe me 45 vota kundër të opozitës. Partia Socialiste ka miratuar kështu buxhetin nen për nen dhe ka rrëzuar të gjitha amendamentet për Buxhetin e vitit 2018. Konkretisht, 16 nga amendamentet ishin propozuar nga PD, 3 nga LSI dhe 1 nga deputeti socialist Ilir Beqja. Kështu, me 73 vota kundër dhe 47 pro është rrëzuar amendamenti i opozitës për pr/ligjin për taksat dhe është miratuar me 72 vota varianti i propozuar nga mazhoranca. Ndërsa me 72 vota pro të mazhorancës, 45 kundër të opozitës dhe 1 abstenim, është miratuar pr/ligji për tarifat doganore. Kuvendi, gjithashtu, nuk e ka miratuar amendamentin e Partisë Demokratike të propozuar nga deputetja Fatbardha Kadiu. Amendamenti që propozonte uljen e tatimit mbi të ardhurat personale, është votuar me 47 vota pro dhe 73 vota kundër. Lidhur me këtë amendament, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, u shpreh se "Taksën e sheshtë që kërkon PD-ja, do ta rrëzojmë. Ju kërkoni të rrisni taksat, ne vazhdojmë t'i ulim",-tha Ahmetaj. Mazhoranca ka lënë në fuqi paketën fiskale, duke mos lejuar ndryshimet për sistemin e taksave, të propozuara nga demokratët dhe as ato për dhënien e koncesioneve. I vetmi propozim i ri i miratuar ka qenë ai për përjashtimin e pensionistëve nga taksa për banesën.

Në vitin 2018 qeveria pret të realizojë të ardhura në masën 200 milionë euro më shumë se në 2017. Rreth 21 milionë euro do të vijnë nga taksa mbi pronën, për shkak të ndryshimit të skemës. Zbatimi i formulës së re të taksimit mbi pronën, nga fikse, në bazë të vlerës, pritshmëria për të ardhurat nga taksa e pronës është rritur ndjeshëm në raport me programin afatmesëm të financave. Arkëtimi nga taksa e pronës pritet të rritet me 54%, për të arritur në 8.1 miliardë lekë më shumë së në 2017.



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

### TË ARDHURAT E SHPENZIMET

Ministria e Financave ka hartuar tabelat e Buxhetit të vitit 2018. Sipas planit, totali i të ardhurave për vitin 2018 pritet që të arrijë 464.3 miliardë lekë (rreth 3.4 miliardë euro), me një rritje prej 6.4% në krahasim me aktin normativ 2017, apo rreth 200 milionë euro më shumë se të ardhurat që pritet të mblidhen këtë vit. Në raport me prodhimin e brendshëm bruto, të ardhurat pritet të arrijnë që në vitin 2017 një nivel rekord prej 28.1% të PBB-së dhe ky nivel pritet që të ruhet edhe përgjatë vitit 2018. Parashikimi i fundit zyrtar për rritjen ekonomike, sipas programit afatmesëm të qeverisë është për një rritje ekonomike prej 4.1% dhe një inflacion prej rreth 2%, çka nënkupton që projektimi real për rritjen e të ardhurave, duke hequr rritjen ekonomike dhe inflacionin është minimal. Vitin e ardhshëm qeveria do të shpenzojë 3.7 miliardë euro përmes buxhetit të shtetit. Qeveria do të shpenzojë 1.1 miliardë euro për pensionet, ndihmën ekonomike dhe transfertat e tjera sociale për shtresat vulnerabël.



## Ilir Beqaj

**VËREJTJA**

Ish-ministri Ilir Beqaj ka folur dje, në seancën e Kuvendit teksa i ka tërhequr vëmendjen kolegëve të tij për konsumin e duhanit në ambientet Kuvendit. "Mua më duket kontraverse, por mbrojtjen e shëndetit nga duhani vendosëm ta bëjmë me tri elemente: me inspektim, promocion dhe fiskalitet. Duhet të pranojmë se inspektimi çalon. Vendi ku shkelet ky ligj është pikërisht kafja e parlamentit këtu…" - tha Beqaj, teksa iu drejtua kolegëve.

### Ministri i Jashtëm takon këshilltarin e Trump për Sigurinë

## Bushati: Shqipëria e angazhuar për një luftë frontale kundër terrorizmit

Gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati u takua me këshilltarin e Presidentit amerikan për Çështjet e Sigurisë, Gjeneralin McMaster. Në këtë takim, i cili u përqendrua te sfidat e sigurisë në rajon ishin të pranishëm ministrat e Jashtëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ministri Bushati vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm mes të dy vendeve dhe falënderoi përfaqësuesin e lartë amerikan për mbështetjen që i ka dhënë Shqipërisë në ngritjen e kapaciteteve ushtarake në fushën e mbrojtjes si dhe asistencën për institucionet ligjzbatuese shqiptare në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ai rikonfirmoi angazhimin e Shqipërisë për të vijuar mbështetjen e iniciativës së Presidentit Trump për një luftë frontale kundër terrorizmit në kuadër të koalicionit global si dhe për angazhimin e Shqipërisë për të kontribuar aktivisht në operacionet paqeruajtëse të Aleancës Atlantike në zonat konfliktuale. Gjenerali McMaster vlerësoi kontributin e Shqipërisë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm e radikalizmit dhe pozicionimin e saj të qartë në funksion të stabilitetit demokratik në rajon. Më herët, Bushati mori pjesë në konferencën me temë "Stuhi e ardhshme? Formimi i së ardhmes në Ballkan në një epokë pasigurie", organizuar nga Këshilli Atlantik. "Kontributin e Shteteve të Bashkuara dhe koordinimin e saj me Bashkimin Evropian e shoh shumë të rëndësishëm të paktën në tri fusha: sa i përket reformave në fushën e sigurisë, sundimin e së drejtës në ekonomi dhe çështje që kanë lidhje me zhvillimin ekonomik, aq më tepër kur sfidat me të cilat po përballet rajoni ynë, janë sfida si për Bashkimin Evropian edhe për SHBA-të", - tha Bushati.



### Kreu i Grupit të LSI-së: 93.1 për qind e të papunëve pa ndihmë

## Petrit Vasili: Mijëra të papunë në Shqipëri qeveria regjistron punësime imagjinare

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili tha dje, se 93.1% e të papunëve në Shqipëri nuk kanë një ndihmë financiare. Për Vasilin qeveria regjistron "mijëra punësime imagjinare", dhe se këto shifra janë "fytyra sociale e vërtetë objektive, që tregon ILO (Organizata Botërore e Punës). "Treguesit janë kokëfortë dhe shumë dëshpërues. Dhëntë zoti që kryeministri të mos ta quajë edhe ILO-n si organizatë kazani, se po ta vendosë e bën ai, nuk trembet hiç, në fund të fundit aq kupton",- shkruan Vasili. "Vetëm 6.9% e të papunëve në Shqipëri marrin një mbështetje financiare. Shqipëria është e 12-ta nga fundi në klasifikimin botëror për këtë tregues. Qeveria është e "qetë", nuk ka nevojë t'u japë asnjë ndihmë të papunëve, le ta përplasin kokën ku të duan, le t'i bëjnë derman vetes vetë. Qeveria s'ka kohë të merret me këto punë",-u shpreh me ironi Vasili, përmes një statusi në "FB". "Qeveria regjistron mijëra punësime imagjinare, raporton ulje papunësie inekzistente, rrëfen ulje varfërie të paqenë. Kjo është fytyra sociale e vërtetë objektive, që tregon ILO (Organizata Botërore e Punës). Kryeministri le te vazhdojë shfaqjet e tij humoristiko - politike për papunësinë e mbështetjen sociale. Treguesit janë kokëfortë dhe shumë dëshpërues. Dhëntë zoti që kryeministri të mos ta quajë edhe ILO-n si organizatë kazani, se po ta vendosë e bën ai, nuk trembet hiç, në fund të fundit aq kupton…",-u shpreh Vasili.



Petrit Vasili



**DEKLARATA**

"Nëse marrëveshja ka vdekur, zoti Zguri është dëshmori i parë i vetë marrëveshjes. Mendoj që nuk është sot momenti për ta bërë këtë debat. Ajo që tashmë kishte të bënte me mospërdorimin e shumicës për t'i dhënë fund këtij debati me logjikën e shumicës, siç e bëtë ju. Ta mbyllim me kaq. Ta bëjmë një diskutim se nuk vjen gjë e keqe nga diskutimi. Ju mund të qëndroni në pozicionin tuaj, ne në tonin",- u shpreh Rama.



## Deputeti i PDIU-së lë mandatin

### Bujar Muça: Nuk realizoj dot premtimet e qytetarëve

Deputeti i PDIU-së në qarkun e Elbasanit Bujar Muça, dha dje dorëheqjen nga mandati i deputetit. Në një kërkesë drejtuar KQZ-së që më 24 nëntor, ai sqaron: "Duke parë që për shkak të rrethanave të ndryshme politike, forca politike që unë përfaqësoj nuk i arriti objektivat e veta dhe, si rrjedhojë, unë nuk po gjej hapësirat e duhura për mbajtjen e premtimeve ndaj qytetarëve, mbështetësve dhe votuesve të mi, duke pamundësuar zgjidhjen sa më shumë të jetë e mundur e problemeve të tyre dhe përfaqësimin në mënyrë optimal të interesave të tyre, kam vendosur të jap dorëheqjen". Sipas procedurave, Bujar Muça duhet t'i drejtohet Kuvendit të Shqipërisë për vendimin e tij të lënies së mandatit. Më pas Kuvendi pasi njihet me kërkesën ia dorëzon KQZ, e cila vendos për zëvendësimin e tij. Përpara marrjes së mandatit në qershor të vitit 2017, Bujar Muça është marrë me biznes ndërsa sipas formularit të vetëdeklarimit të tij, bie në sy se deputeti Bujar Muça ka mbajtur edhe një identitet tjetër më parë, me emrin Luan, ndërsa nuk i kujtohej mirë se ku kishte lindur dhe datën e lindjes, ku në krah të saj, ka shënuar datën 5 gusht 1971, dhe në kllapa ka shkruar "me sa më kujtohet". Kandidatja e radhës që merr mandatin është pedagogia Elena Xhina, e cila në një prononcim për "Gazeta Shqiptare" u shpreh dje se do të vendosë për mandatin, pasi të përfundojnë procedurat e Muçës.

### Opozita kundërshton nismën, Bylykbashi: Nuk është çështje e Kuvendit

# Shkarkimi i Zgurit, PS tërheq kërkesën, Rama: Dialog me opozitën

## "Nëse ka vdekur pakti i 18 majit, Zguri dëshmori i parë"



Kryetari i KQZ-së, Klement Zguri

**KRYEPROKURORI**

Konferenca e Kryetarëve nuk vendosi asgjë dje, në lidhje me mandatin e Kryeprokurorit Adriatik Llalla. Maxhoranca pritet të mos ketë një nismë për ta shkarkuar, ndërkohë skenarët mbeten të hapur. Mundet që vetë Kuvendi të nisë procedurat për emrin e ri, ose Llalla mund të qëndrojë në detyrë deri në përfundim të vetingut.

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama pranoi dje, kërkesën e Partisë Demokratike për të hequr nga kalendari tre javor i punimeve të Kuvendit kërkesën për shkarkimin e kryetarit të KQZ-së, Klement Zguri. Edhe pse kërkesa e PS-së ishte bërë zyrtare, bashkë me firmat e deputetëve, ajo hasi në kundërshtinë e opozitës fillimisht në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe më pas edhe në mbyllje të seancës së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi propozoi që kalendari të hidhej në votim, pasi nuk kishte kaluar me konsensus pikërisht për shkak të kësaj kërkese. Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi propozoi që kërkesa të tërhiqej, duke shtuar se ajo ishte joligjore dhe e pambështetur në prova e fakte. Po ashtu kërkesën për tërheqje të kërkesës socialistëve ua bëri edhe kreu i republikanëve Fatmir Mediu, i cili hodhi propozimin që të uleshin e të diskutonin, në kuadër edhe të reformës zgjedhore. Në këtë moment reagoi kryeministri Edi Rama, i cili pranoi kërkesën e Mediut, me propozimin që të hapet dialog me opozitën. "Unë propozoj që ne mos ta përfshijmë në kalendar, ta marrim në konsideratë kërkesën e opozitës, pa pjesën retorike të kërkesës që bëri zoti Mediu, pastaj të shfrytëzojmë kohën për të diskutuar, ta bëjnë në mënyrë që të kuptojmë qartë për qëllimet në rastin konkret që kanë pasur deputetët që kanë firmosur propozimin",-u shpreh Rama. Në këtë moment edhe kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla u shpreh dakord me propozimin e kryeministrit, por pyeti kreun e PD-së nëse marrëveshja e 18 majit ka vdekur. Basha u përgjigj duke thënë se këtë marrëveshje e vrau PS. "Ligji thotë që të shkarkohet kryetari i KQZ-së duhet të vijë propozim nga 5 anëtarë të KQZ-së. E motivi me të cilin doni të shkarkoni Klement Zgurin është i rremë. Qëndrimi që ka mbajtur Zguri për rastin e kryetarit të Mallakastrës është qëndrimi që ka mbajtur Denar Biba. Ju kërkoj që bashkë me reflektimin e sotëm të kërkoni ndjesë për këtë shkelje flagrante të ligjit. Ju kërkoj të mos e pranoni, ta refuzoni, jo si favor, as si mëshirë, por si detyrim ligjit për ta hequr nga programi",-u shpreh Basha. Debati vijoi më tej me përgjigjen e kryeministrit Rama. "Nëse marrëveshja ka vdekur, zoti Zguri është dëshmori i parë i vetë marrëveshjes. Mendoj që nuk është sot momenti për ta bërë këtë debat. Ajo që tashmë kishte të bënte me mospërdorimin e shumicës për t'i dhënë fund këtij debati me logjikën e shumicës, siç e bëtë ju. Ta mbyllim me kaq. Ta bëjmë një diskutim se nuk vjen gjë e keqe nga diskutimi. Ju mund të qëndroni në pozicionin tuaj, ne në tonin. Mund të gjejmë një pozicion tjetër, kjo është diçka që do të varet nga diskutimi", - u shpreh Rama.

**DEBATET**

- **Gramoz Ruçi:** Sot u mblodh Konferenca e Kryetarëve dhe patëm vetëm një çështje për kalendarin e punimeve që nuk u ra dakord, ajo e problemit të kërkesës së bërë nga deputetët e PS-së për shkarkimin e kryetarit të KQZ-së, Klement Zguri. Ndaj kur nuk ka mirëkuptim procedohet me votim.
- **Oerd Bylykbashi:** Keni futur këtë kërkesë në kalendar, por ju paralajmëroj që është totalisht e paligjshme, sepse nuk respekton parashikimet e Kodit Zgjedhor. Kërkesa është e pabazuar, jo vetëm në prova, në fakte, por edhe në kundërshtim me Kushtetutën. Jeni duke cenuar pavarësinë e institucioneve të tjera. Nuk është çështje që e bën Kuvendi. Kërkesa për shkarkim vjen vetëm nga KQZ. Ju them ta tërhiqni këtë nismë.
- **Gramoz Ruçi:** Unë nuk tërheq gjë, ka një nismë dhe unë vetëm programoj. Jeni ju që e diskutoni
- **Fatmir Mediu:** U bëj thirrje firmëtarëve të kësaj kërkese, sepse bie tërësisht ndesh me Kodin Zgjedhor. Asnjë grup deputetësh nuk ka kompetencë të propozojë shkarkimin e kreut të KQZ-së. Është kompetencë e KQZ-së që vendos me 5 vota për këtë shkarkim. Në thelb shkaku i prezantuar i deputetëve të PS-së nuk përfshihet në shkaqet për ta shkarkuar. Unë do të propozoj tërheqjen e kërkesës. Jemi në fazën që jemi ulur me njëri-tjetrin për të bërë reformën zgjedhore dhe duhet të ulemi të diskutojmë.
- **Edi Rama:** Jam shumë dakord që të ulemi për të gjetur rrugën e arsyes dhe për të dalë nga ky lloj ngërçi. Pra, unë propozoj që ne mos ta përfshijmë në kalendar, ta marrim në konsideratë kërkesën e opozitës, pa pjesën retorike të kërkesës që bëri zoti Mediu pastaj të shfrytëzojmë kohën për të disktuar, ta bëjnë në mënyrë që të kuptojmë qartë për qëllimet në rastin konkret që kanë pasur deputetët që kanë firmosur propozimin.
- **Taulant Balla:** Propozimi i kryeministrit është i drejtë. Ne do ta mbështesim.

**Reagojnë deputetët e PD-së, duke krijuar ilaritet në sallë**

- **Balla:** Duroni, duroni...Unë kam një pyetje për PD-në: Marrëveshja e 18 majit vazhdon? Kjo kërkesë e deputetëve nuk ka rënë. Nuk përfshihet në kalendar, por është në program në rast se nuk shqyrtohet në kalendarin 3-javor kalon në programin e ardhshëm.
- **Lulzim Basha:** Marrëveshjen e vratë ju. Marrëveshja arsyeja e dytë është, sepse ligji nuk mund të jetë çështje marrëveshjesh. Interpretimi i ligjit nuk mund të jetë çështje arbitrariteti. Ligji thotë që të shkarkohet kryetari i KQZ-së duhet të vijë propozim nga 5 anëtarë të KQZ-së. E motivi me të cilin doni të shkarkoni Klement Zgurin është i rremë. Qëndrimi që ka mbajtur Zguri për rastin e kryetarit të Mallakastrës është qëndrimi që ka mbajtur Denar Biba. Ju kërkoj që bashkë me reflektimin e sotëm të kërkoni ndjesë për këtë shkelje flagrante të ligjit. Ju kërkoj të mos e pranoni, ta refuzoni, jo si favor, as si mëshirë, por si detyrim ligjor për ta hequr nga programi.
- **Edi Rama:** Nuk e kuptova ça deshe që e përmbyte prap seancën. Ramë dakord ta mbyllim. Në reagimin që bëri zoti Mediu unë bëra një propozim të arsyeshëm as për mëshirë dhe për asnjë nga ato aspekte retorike që tha zoti Mediau, po për të hapur një rrugë dialogu me ju.

Pyetja e Tualantit që të ngriti me shpejtësi përpjetë ka lidhje, sepse është marrëveshja që krijoi atë konfiguracion në KQZ, është marrëveshja që e bëri zotin Zguri kryetar. Edhe nëse marrëveshja ka vdekur, zoti Zguri është dëshmori i parë i vetë marrëveshjes. Mendoj që nuk është sot momenti për ta bërë këtë debat. Ajo që tashmë kishte të bënte me mospërdorimin e shumicës për t'i dhënë fund këtij debati me logjikën e shumicës, siç e bëtë ju. Ta mbyllim me kaq. Ta bëjmë një diskutim se nuk vjen gjë e keqe nga diskutimi. Ju mund të qëndroni në pozicionin tuaj, ne në tonin. Mund të gjejmë një pozicion tjetër, kjo është diçka që do të varet nga diskutimi. Ajo që ishte thelbi i propozimit që bëri zoti Mediu ishte mos e fusim në kalendar. Këtë dëgjova dhe propozimi im ishte që të mos futet në kalendar. Për të tjerat ka të drejtë Taulanti, sipas meje. Ju thoni: jo. Kjo i takoni diskutimit më pas. S'kemi ca diskutojmë këtu se unë gati jam të dal prap aty, por do bëhet përmbytje e madhe pastaj Lulzim. Më mirë e mbyllim me kaq.

- **Lulzim Basha:** Vendimi për ta hequr nga kalendari është vendim i drejtë. Motivet nuk janë të drejta. Mund ta hiqni nga kalendari dhe nga programi. Ligji është i qartë. Mos humbisni kohë. Edhe ne opozita do të jemi në terren.

## Gjykata e Korçës lë në burg 29-vjeçarin Spiro Naçi

# Aksidentoi eskortën e Ramës, autori iu kërkon ndjesë gardistëve: E bëra pa dashje


Drejtuesi i mjetit Spiro Naçi

**KORCE**- Gjykata e Korçës ka dhënë dje masën e sigurisë arrest me burg për Spiro Naçin, drejtuesin e mjetit që akuzohet se shkaktoi aksidentin në Korçë me eskortën e kryeministrit. Gjykata e Shkallës së Parë, ka vendosur të lërë në fuqi kërkesën e prokurorisë për 29-vjeçarin. Gjatë seancës gjyqësore Spiro Naçi ka deklaruar se aksidentin e ka shkaktuar pa dashje dhe iu ka kërkuar ndjesë gardistëve. "Në vendin ku ndodhi aksidenti ka qenë vija e ndërprerë që lejon parakalimin, prandaj edhe parakalova. Iu kërkoj ndjesë gardës se pa dashje i kam shkaktuar shqetësim. Ndjesë i kërkoj edhe familjes time që i kam shqetësuar",- ka thënë ai. Aksidenti ndodhi mesditën e 27 nëntorit në aksin rrugor Maliq-Korçë pranë fshatit Bulgarec. Në aksident janë përfshirë 4 automjete, dy të eskortës së kryeministrit, një mjet tip "Volkswagen" me targë AA 426 FD dhe një "Range Rover" me targë AA 313 DX. Si pasojë e përplasjes janë dëmtuar tre punonjës të Gardës K.Ll, E.M, dhe Sh.P, të cilët ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Paraprakisht mësohet se mjeti tip "Volkswagen", i drejtuar nga Spiro Naçi që udhëtonte në krah të kundërt me eskortën, duke mos respektuar largësinë dhe për shkak të shpejtësisë e lagështisë në rrugë, ka goditur makinën tip "Range Rover" e drejtuar nga një femër që udhëtonte para tij, e më pas makinën e katërt në radhë të eskortës, e cila ka dalë nga rruga. Dëmtime të vogla ka marrë edhe mjeti tip "Mitsubishi" që ishte pjesë e eskortës.

### Policia dyshime se shpërthimi lidhet me konkurrencën në aktivitetin e tij privat

# Tritol në makinë, biznesmeni i inerteve: S'kam konflikte

## *Rajta: Nuk e di kush janë autorët e këtij akti*

Ina Allkanjari

**TIRANË**

Një automjet u shkatërrua plotësisht mëngjesin e djeshëm në Tiranë, nga aktivizimi i një sasie eksplozivi. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 09:45, në rrugën dytësore të Unazës së Re, pranë Liqenit të Thatë. Mësohet se fuqia shpërthyese ka qenë shumë e madhe, por nuk ka persona të lënduar pasi automjeti në momentin e shpërthimit ka qenë në parkim.

Bëhet fjalë për automjetin tip "Volswagen" me targë AA 946 EE, në pronësi të të shtetasit Ndok Rajta. Bëhet me dije se 42-vjeçari Rajta është biznesmen në fushën e inerteve, banues në lagjen "Ali Demi" në Tiranë. Menjëherë pasi u sinjalizuan për shpërthimin, forcat policore mbërritën në vendngjarje dhe nisën hetimet për zbardhjen e plotë të saj. Ekspertët verifikuan provat materiale në mjetin tip " Volswagen" dhe bëhet me dije se copëzat e makinës janë përhapur në një distancë rreth 70 metra. Nga veprimet paraprake, policia bën me dije se në momentin e shpërthimit, makina ka qenë e parkuar pikërisht pranë pikës së grumbullimit të inerteve. Sipas uniformave blu, dyshohet se automjetit i është vendosur sasia e tritolit pas orës 7:30 kur drejtuesi i saj e parkoi. Nga verifikimi i vendit të ngjarjes, policia konstatoi se autorët kanë aktivizuar një sasi prej rreth 200 deri 300 gram lëndë plasëse e llojit C4, në pjesën e poshtme të makinës. Ndërkohë, pronari i makinës Ndok Rajta shpjegoi gjatë marrjes së tij në pyetje se nuk ka pasur konflikt me askënd dhe se nuk ka ndonjë ide për autorët e këtij akti. Sipas të dhënave të para, dyshohet se shpërthimi mund të jetë një mënyrë kërcënimi apo shantazhi ndaj administratorit të një firme inertesh, Ndok Rajta. Gjithashtu, grupi hetimor dyshon se atentati i mbetur në tentative ndaj 42-vjeçarit, lidhet me konkurrencën në aktivitetin e tij privat. Dyshohet se mekanizmi i shpërthimit është menaxhuar me komandim në distancë, por deri më tani policia nuk ka persona të dyshuar për ngjarjen. Sakaq policia bën të ditur se Rajta nuk ka precedent penal, por po hetohet edhe për ndonjë hasmëri të vjetër.



Makina e dëmtuar nga eksplozivi

**DËSHMIA**

Pronari i makinës Ndok Rajta shpjegoi gjatë marrjes së tij në pyetje se nuk ka pasur konflikt me askënd dhe se nuk ka ndonjë ide për autorët e këtij akti. Sipas të dhënave të para, dyshohet se shpërthimi mund të jetë një mënyrë kërcënimi apo shantazhi ndaj tij.

**NGJARJA**

Me datë 30.11.2017, rreth orës 09:45, te Liqeni Artificial ka shpërthyer një automjet. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e policisë ku nga veprimet paraprake ka rezultuar se te Liqeni Artificial, në rrugën dytësore ka shpërthyer një mjet i parkuar me targë AA946EE tip "Volkswagen", në pronësi të shtetasit Ndok Rajta , 42 vjeç, administrator i një firme inertesh. Si pasojë makina u dëmtua tërësisht si dhe u thyen xhamat e një objekti që ndodhet pranë vendit ku ishte parkuar automjeti. Mësohet se nga shpërthimi nuk pati të lënduar. Sakaq grupi hetimor po kryen veprimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

## SHKURT

### Të riut në Sarandë i djegin karrotrecin, dyshohet për zjarr vënie të qëllimshme

**SARANDE**- Një mjet tip karrotrec ka marrë flakë gjatë mbrëmjes së mërkurë në Sarandë. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 01:50 teksa salla operative Sarandë është njoftuar nga një telefonatë se në lagjen numër 1, pranë një servisi, ka marrë flakë një mjet karrotrec. Policia ka shkuar pranë vendit të ngjarjes dhe nga verifikimi paraprak ka rezultuar se mjeti karrotrec, në pronësi të shtetasit A.M., 34 vjeç, banues në Gjashtë, ka qenë i parkuar përpara servisit të tij, dhe si pasojë e flakëve të zjarrit ka marrë dëmtime në rrotën e parë të kahut të majtë të mjetit. Dyshohet se zjarr vënia ka qenë e qëllimshme, pasi nga këqyrja e kamerave është vënë re një shtetas, i cili është afruar pranë servisit. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e kapjen e autorit.

### Qëllohet me armë drejt një banese në Patos, në kërkim autorët

**FIER** - Një ngjarje e rëndë është regjistruar në datën 29 nëntor në Patos, ku persona të pa identifikuar kanë qëlluar me armë në drejtim të një banese. Mësohet se ngjarja ndodhi rreth orës 20:55, në lagjen "Dukas", në banesën në pronësi të shtetasit E.H, 58 vjeç. Fatmirësisht nga të shtënat nuk ka pasur të lënduar. Materialet i kaluan prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" parashikuar nga Nenet 84 dhe 278 të Kodit Penal.

## 52-vjeçari dënohet me 35 vjet, shkak gjykimi i shkurtuar

# Hodhi gruan nga dritarja, Ferdinand Ruko i shpëton burgut të përjetshëm


Ferdinand Ruko

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka shpallur dje vendimin për shtetasin Ferdinand Ruko, i cili hodhi gruan e tij Liljana Ruko nga ballkoni. Gjykata e Shkallës së parë dënoi me burgim të përjetshëm Ferdinand Rukon, por pas procesit të shkurtuar, pasi pranoi krimin, ai u dënua me 35 vite burg. 52-vjeçari muaj më parë shprehu pendesë për krimin. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në banesën e çiftit në qytetin e Fierit në lagjen "Kryengritja", më 3 dhjetor të 2016-ës. Sipas hetimeve, shkak për krimin ishin grindjet e vazhdueshme të çiftit për motive të dobëta. Për viktimën, gjykata e Fierit kishte lëshuar dhe urdhërmbrojtje, por pavarësisht kësaj, çifti Ruko vazhdonte të jetonte nën një çati. Ferdinand Ruko ka pranuar para 2 muajve përpara hetuesve se hodhi gruan Liljana Ruko nga dritarja e banjës së katit të katërt, pas një sherri që pati me të. "Dyshoja te gruaja ime, u zumë dhe debatuam ashpër. E futa në banjë, e zhvesha, e rraha dhe pastaj e hodha nga dritarja",- ka thënë para hetuesve 52-vjeçari. Bashkëshortja e tij 43-vjeçare, nënë e dy fëmijëve gjeti vdekjen e menjëhershme.

Korrupsioni, ish-zëvendësi deklaroi në gjyq se i dha biznesmeni 20 mln lekë

# Ish-kreu i Burgjeve: S'kam faj, me Labin kam pasur marrëdhënie të ngrira

## Artur Zoto-prokurores: Ju e dini pse jam këtu

TIRANE

Ish-drejtori i Burgjeve, Artur Zoto, i cili akuzohet për "Korrupsion pasiv" gjatë një procedure tenderimi të ushqimit në burgje, pretendon pafajësinë. Zoto është marrë dje sërish në pyetje pranë Krimeve të Rënda, ku tregoi edhe raportet institucionale që kishte me zv.drejtorin e Burgjeve, Iliaz Labi. Kjo seancë u zhvillua dy javë pasi ish-vartësi i tij Labi tha në sallën e gjyqit se i kishte dorëzuar në zyrë 2 milionë lekë ryshfet Artur Zotos. Para trupës gjykuese ish-drejtori i Burgjeve ka mohuar kategorikisht akuzat dhe përfshirjen e tij në këtë aferë korruptive. Më herët në seancën e 15 nëntorit gjatë dëshmisë së tij Labi theksoi se biznesmeni Shemsi Sinani i ka dhënë 20 milionë lekë te një lokal te Blloku, të cilat duhet t'ia jepte ish-drejtorit. Ndërkohë Artur Zoto shprehet se nuk ka bërë asnjë faj dhe se marrëdhëniet me Labin ishin të ngrira. "Nuk kam asnjë faj. Me Iliaz Labin kam pasur komunikim të ngrirë. Ai nuk ka qenë asnjëherë në zyrën time. Madje nuk kam pasur asnjë komunikim dhe as takim me biznesmenët. Nëse jam këtu për gjëra të tjera, e dini ju. Gjykata të ngrejë një komision të veçantë që të verifikojë tenderin për të cilin akuzohem",- tha Zoto. I pandehuri Zoto përjashtoi veten edhe nga kontaktet me pesë biznesmenët garues për tenderin, të pandehur në një procedim të veçuar. "Nuk i njoh pesë biznesmenët. Nuk kam pasur ndonjëherë komunikim telefonik me ta. As nuk i kam takuar ndonjëherë dhe as adresuar njeri që t'i takojë",-tha ai.

**AKUZA**

Ish-drejtori i Burgjeve,


Ish-drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Artur Zoto


Ish-zv.drejtori i Burgjeve, Iliaz Labi

Artur Zoto dyshohet se është i përfshirë në korrupsionin me tenderët e ushqimeve, për të cilat u arrestua edhe zv/drejtori i Burgjeve Iljaz Labi. Një seri bisedash të përgjuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, kanë ngritur dyshime të forta për implikimin të Zotos në aferat korruptive në tenderët e ushqimit në burgje. Në dosjen hetimore, ndodhen dhjetëra procesverbale me biseda të transkriptuara, të cilat tregojnë se drejtori Zoto, tashmë i dorëhequr ka qenë në dijeni të këtyre aferave korruptive, dhe se Iljaz Labi nuk bënte asnjë hap, pa miratimin e tij. Dy ditë pas operacionit të arrestimit të zëvendësit të tij, Iljaz Labi dhe katër biznesmenëve Elidjan Laskaj, Ylber Kalaja, Shemsi Sinani e Nexhmi Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka dhënë dorëheqjen, duke ia justifikuar largimin ministrit të Drejtësisë, Manjani nëpërmjet një letre, ku i shkruante se ishin motivet personale dhe familjare të tij, që e çonin në largimin nga kjo detyrë. Në një seri bisedash të përgjuara, pasqyrohet dhe një bisedë mes biznesmenëve Nexhmi Balla dhe Elidjan Laskaj, ku Nexhmiu e pyet Elidjanin se çfarë kishte bërë. Nga ana tjetër Elidjani i thotë se sa kishte dalë nga Drejtoria e Burgjeve.

## Voda: Procedim kompanive turistike që abuzojnë

### Riatdhesohen 41 shtetas nga Franca dhe Gjermania


Rovena Voda

41 shtetas shqiptarë, të cilët kanë kërkuar azil në Francë dhe Gjermani janë riatdhesuar dje në Rinas. Gjatë kthimit të tyre në aeroport ka qenë e pranishme edhe zëvendësministrja e Brendshme Rovena Voda. Në një prononcim për shtyp zëvendësministrja ka deklaruar se do të ketë procedim për kompanitë turistike që abuzojnë me azilkërkimin."Vetëm gjatë muajit nëntor janë riatdhesuar 500 shtetas shqiptarë të kthyer nga shtete si Franca, Belgjika dhe Gjermania. Sigurisht numri është në rritje, operacionet e riatdhesimit dhe kthimit në atdhe të shtetasve shqiptarë janë në rritje, pasi kërkesat për azil të shtetasve shqiptarë kanë shansin zero për t'u pranuar. E theksoj sërish që Shqipëria është në listën e vendeve të sigurta dhe mundësitë për shtetasit shqiptarë për të kërkuar azil janë zero", - tha Vodo.

SHKURT

### Vodhi çantën me 4500 euro në një lokal në Sarandë, kapet pas 6 ditësh autori

**SARANDE** - Policia ka mundur të vërë në pranga autorin, i cili disa ditë më parë i ka vjedhur një shtetasi një çantë personale me 4500 euro. Specialistët e Seksionit për Krimet në Komisariatin e Policisë Sarandë, ditën e enjte kanë kapur shtetasin Jani Kongjini, 35 vjeç, banues në Himarë. Shtetasi i mësipërm, më datë 24.11.2017, në afërsi të fshatit Çukë, pranë një pike karburanti, në bar kafe, ka vjedhur një çantë personale, në brendësi të saj me sendet identifikuese personale si edhe me një sasi shume vlerash monetare prej 4500 euro, të cilat i përkisnin shtetasit K.I., i cili kishte bërë edhe kallëzim për këtë fakt.

### Aksident në Vlorë, makina del nga rruga dhe përplaset me një dyqan

**VLORE** - Një aksident rrugor ka ndodhur paraditen e djeshme në qytetin e Vlorës, kur si pasojë ka mbetur i lënduar një person. Ngjarja ka ndodhur në rrugën "Sulejman Delvina", pranë vendit të quajtur "Kryqëzimi i 7 pallateve". Menjëherë sa ka marrë njoftim për ngjarjen, policia e Vlorës ka shkuar në vendngjarje, dhe nga verifikimi paraprak ka rezultuar se mjeti tip "Benz", i drejtuar prej shtetasit Ervin Dedaj, 42 vjeç, ka humbur kontrollin, dhe për pasojë është përplasur me dyqanin e shtetasit Engjëll Bilalaj, i cili në atë moment ishte duke hapur qepenin e dyqanit. Mësohet se nga përplasja e mjetit me dyqanin, ka vetëm dëme materiale.


United Nations Development Programme

UN DP Empowered lives. Resilient nations.

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

| | |
|---|---|
| **Post Title:** | National Consultant on Ethnographic Research |
| **Type of Contract:** | Individual Contract |
| **Project:** | Promoting Inclusive Labour Market Solutions in the Western Balkans |
| **Duty Station:** | Tirana, Albania |
| **Duration of Assignment:** | 15 working days during the period of December 2017 - January 2018 |
| **Deadline for Application:** | December 8, 2017 |
| **Job Description:** | http://al.undp.org |

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/.
Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

STRATI Bailiff Service

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

**-"Pyll", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumi 21, faqe 82, rregjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyzeli-BLB" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010.** Çmimi fillestar i ankandit është **15,120,000 Lekë.**

**-"Pyll" , me sipërfaqe 1000 m² , ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumi 21, faqe 81, regjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Ermira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010.** Çmimi fillestar i ankandit është **2,520,000 Lekë.**

**-"Truall", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² truall dhe 161 m² ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumi 4, faqe 247, rregjistruar në pronësi të Armand Shuaipi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2173 Rep, Nr. 1409/2 Kol, datë 24.08.2010.** Çmimi fillestar i ankandit është **3,133,065.6 Lekë.**

**-"Arë+Truall", me sipërfaqe 4,500 m², nga e cila 400 m² truall dhe 176 m² ndërtesë, ndodhur në Sallmone, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumi 6, faqe 135, rregjistruar në pronësi të Bujar Gjyzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën Tirana sh.a me Kontratë Hipoteke Nr. 657 Rep, Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipoteke Nr. 1512 Rep, Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010.** Çmimi fillestar i ankandit është **9,534,672 Lekë.**

**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.12.2017.**

**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com**

### Anketa, 2,6 mln banorë jetuan me 4 euro në ditë dhe 199,761 persona konsumuan 15 euro

# INSTAT: 93% e shqiptarëve jetuan me 4 euro në ditë

## *Pabarazia rritet me 2.5% në vitin 2016*

Vit për vit, Shqipëria po bën hapa të shpejtë në hendekun e pabarazisë, ku të pasurit bëhen më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Në anketën e buxhetit të familjes për vitin 2016, Instituti i Statistikave (INSTAT) referoi se 90% e familjeve shqiptare shpenzuan mesatarisht 63,609 lekë në muaj. Këto familje, sipas INSTAT, kanë mesatarisht 3.9 anëtarë. 90% e familjeve në fashën e poshtme të konsumit përbëhen nga 2,696,772 persona, të cilët përbëjnë 93% të totalit të popullsisë (2,896,532 banorë). Kuota e shpenzimeve ditore për çdo banor në këtë kategori ishte 544 lekë në ditë, ose 4 euro në ditë për frymë. Llogaritë e "Monitor" tregojnë se, 10% e familjeve që përbëjnë 7% të popullsisë së vendit me 199,761 persona konsumojnë 15 euro në ditë për frymë ose tre herë më shumë se 93%. Shpenzimet mesatare për konsum të NjEF tregojnë se në vitin 2016, ka pasur një rritje më të madhe të shpenzimeve të 10% të NjEF me shpenzimet më të larta (14,6%) në krahasim me rritjen e shpenzimeve mesatare për konsum të 90% tjetër (0,6%) në krahasim me 2015. Shpërndarja e nivelit të shpenzimeve për konsum tregon se 90% e NjEF shpenzon 78,3% të vlerës së konsumit gjithsej, me një mesatare të shpenzimeve për konsum prej 63.609 lekë në muaj. Nga ana tjetër, 10% e NjEF shpenzon 21,7% të konsumit gjithsej, me një shpenzim mesatar prej 158.946 lekë në muaj. Shpenzimet mesatare për konsum të 10% të NjEF me shpenzime më të larta janë 2,5 herë më shumë se ato të 90% tjetër të NjEF. Si rrjedhim, raporti i konsumit të familjeve më 2016, për këtë tregues, paraqet një rritje të pabarazisë nga 2,2 më 2015 në 2,5 më 2016. Jetesa më 4 euro në ditë konsiderohet si varfëri relative sipas standardit të Bankës Botërore. Kategoria e personave në këtë kategori konsumi konsiderohen më shumë në varfëri se sa në jetesë normale.


Foto ilustruese

**NË VITIN 2016**

| Qarku | Shpenzimet mesatare mujore për konsum |
|---|---|
| Tiranë | 85.344 lekë në muaj |
| Durrësi | 77.933 lekë në muaj |
| Shkodra | 75.503 lekë në muaj |
| Gjirokastër | 57.068 lekë në muaj |
| Elbasan | 57.290 lekë në muaj |
| Vlorës | 58.872 lekë në muaj |
| Dibrës | 63.212 lekë në muaj |
| Lezhë | 75.470 lekë në muaj |
| Berat | 64.222 lekë në muaj |
| Fier | 71.242 lekë në muaj |

**STRUKTURA E SHPENZIMEVE**

Struktura e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF sipas 12 grupeve kryesore të konsumit2 tregon se grupi "Ushqime dhe pije jo-alkoolike", i cili ka peshën kryesore në buxhetin familjar me 45,2 %, rezulton me ulje 3,5 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar. Nëngrupet që zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim, janë "qumështi me nënproduktet e tij dhe vezët", 18,1 %, "bukë dhe drithëra" dhe "mish dhe nënprodukte" 17,5 %, ndjekur nga "perimet", 13,9 % dhe "frutat" 8,0 %. Shpenzimet për grupin "pije alkoolike dhe duhan", përbëjnë 3,4 % të buxhetit, në ulje me 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Nëngrupi "duhani" zë peshën kryesore me 62,6 %. Shpenzimet për grupin "veshje dhe këpucë", zënë 4,8 % të buxhetit total, të cilat regjistrojnë ulje prej 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Nëngrupi "veshjet" zë peshën më të madhe në krahasim me nëngrupin "këpucë dhe të ngjashme" me një peshë prej 68,6 %. Grupi i shpenzimeve për banesën, me shpenzimet për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira të paguar dhe riparime të vogla zë 10,2 % të totalit të buxhetit familjar duke shënuar ulje prej 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin e mëparshëm. Rreth 50,3 % e këtyre shpenzimeve shkojnë për pagesën e energjisë elektrike dhe 17,3 % për përdorimin e lëndëve të tjera si gaz, naftë, dru zjarri etj. Shpenzimet që shkojnë për nëngrupin "qira e paguar", kanë një peshë prej 14,1 %, me NjEF që deklaron shpenzime për pagesën e qirasë 6,3 %.

### MIE jep 4 leje minerare

## Investimi 87 milionë lekë për gurin gëlqeror dhe kromin

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar 4 leje minerare, ndërkohë që investimi i parashikuar sipas ofertave të paraqitura nga kompaninë arrin në 87 milionë lekë. Leja e parë është miratuar për shoqërinë "Alflo", e cila do të aplikojë lejen minerare në zonën e Qafë Shtamës për nxjerrjen e mineralit gëlqeror të mermerizuar. Vlera e produkteve minerare që parashikohet të merren nga veprimtaria minerare në këtë zonë është 612 500 000 lekë. Leja e dytë është dhënë për objektin Pishkash, në qarkun e Elbasanit dhe parashikon prodhimin dhe përpunimin e 20 mijë m3 gurë gëlqeror në vit, me një vlerë prej 250 milionë lekë. Leja e tretë është dhënë për shfrytëzimin e kromit në objektin Fusha Kalt, në Dibër. Prodhimi dhe përpunimi që mendohet të realizohet në këtë zonë minerare është 1000 tonë në vit, ndërkohë që vlera e produkteve arrin në rreth 48 milionë lekë. Sa i takon lejes së katërt të miratuar, kontrata parashikon një investim prej 26 milionë lekësh për zbulimin e kromit në zonën e Përroit të Runës në Kukës. Paralelisht, ministria njofton dështimin e 4 procedurave për 4 zona të tjera minerare.


Foto ilustruese

### Depozitat bien në tetor

## Individët tërhoqën 200 mln euro në 10 muaj

Individët tërqesin paratë nga bankat. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, stoku i depozitave në fund të muajit tetor arriti në 995 miliardë lekë, me një rënie prej 0.3% në krahasim me muajin e mëparshëm. Së pari, depozitat në lekë të individëve kanë vijuar tendencën e tyre rënëse që po vazhdon prej disa vitesh, duke reflektuar interesin e pakët për të mbajtur kursimet me afat në banka, për shkak të normave modeste të kthimit, që janë rreth 1% për depozitat me maturim 12 mujor. Totali i depozitave të individëve në lekë, ka zbritur në 260 miliardë lekë, nga 373 miliardë lekë që ishin në dhjetor të vitit 2012. Vetëm gjatë 10 muajve të këtij viti, individët kanë tërhequr rreth 27 miliardë lekë, apo gati 200 milionë euro. Depozitat e individëve përbënin 26% të totalit në tetor, nga 40% që ishte kjo peshë në dhjetor 2012, duke shfaqur një tkurrje të ndjeshme. Së dyti, në tetor është konstatuar dhe një rënie e kursimeve në valutë, të cilat janë reduktuar me 0.3%. Stoku i depozitave në valutë ishte 529 miliardë lekë në tetor, duke përbërë 53% të totalit. Pavarësisht përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për të ulur nivelin e euroizimit në ekonomi, shqiptarët duket se vijojnë që t'i besojnë monedhës së përbashkët, pasi pjesa më e madhe e kursimeve, në një vend që ka si monedhë zyrtare lekun, janë në euro. Me bazë vjetore (tetor 2017/tetor 2016), depozitat në total janë rritur vetëm me 0.3%, duke shënuar të dytin vit radhazi me ritme të ngadalta zgjerimi. Ky ngadalësim ka ardhur tërësisht nga tkurrja e kursimeve në lekë të individëve (-30 miliardë lekë), ndërsa bizneset kanë pasur një sjellje tërësisht të kundërt, teksa në një vit i kanë rritur kursimet me 15% (19 miliardë lekë), në një tjetër sinjal (krahas ngadalësimit të kredisë) se investimet në ekonomi janë frenuar.


Banka e Shqipërisë



**Afati i fundit i dorëzimit të dosjeve, si do të përzgjidhen fituesit**

# Fillon aplikimi për mësuesit e papunë

Gjatë muajit dhjetor, të gjithë mësuesit e papunë, të rinj apo të vjetër, do të kenë mundësinë të garojnë për të siguruar një vend pune në sistemin arsimor në vend. Mësuesit tashmë, mund të konkurrojnë në portalin "Mësues për Shqipërinë", ndërkohë që Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë bën me dije se Drejtoritë Arsimore në vend dhe Zyrat Arsimore kanë marrë udhëzimin për të përcaktuar afatet e pranimeve të dosjeve të aplikantëve. Por afati i fundit i dorëzimit të dosjeve nga ana e mësuesve nuk duhet të jetë më larg se data 22 dhjetor e këtij viti. Ndërkaq, faza e dytë është provimi, i cili do të zhvillohet në janar të 2018-ës. Por, kandidatët duhet të tregohen shumë të kujdesshëm gjatë konkurrimit me dosje dhe të sigurohen se i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore, në të kundërt mund të skualifikohen. Faza e parë e aplikimit, pra dorëzimi i dosjeve vlerësohet me 30 pikë nga 100 pikë. Ndërkaq, testimi vlerësohet me 70 pikë dhe në këtë mënyrë bëhet dhe renditja e kandidatëve në bazë të pikëve që do të grumbullojnë në total. Ky portal do të punësojë ata aplikantë që paraqesin rezultate më të larta, për të plotësuar në këtë mënyrë, vendet e mbetura bosh në shkollat në të gjithë vendin.

**Peticioni drejtuar Bashkisë së Tiranës: Ju lutem na ndihmoni**

# Rruga "Qamil Buxheli" në kryeqytet, vatër infeksioni

## *Banorët: Jemi në pritje të një përgjigjeje*

Voltiza Duro

Pa ndriçim, e paasfaltuar, pa trotuare, pa kanalizime e tashmë me reshjet e dendura të shiut është bërë e pakalueshme. Kjo është gjendja e rreth 60 metra të rrugës "Qamil Buxheli", pranë ish-kombinatit "Misto Mame" në kryeqytet, prej së cilës preken rreth 50 banorë që iu duhet të përballen përditë me këto kushte. Nisur nga e gjithë kjo, rreth 20 kryefamiljarë të kësaj zone, kanë nënshkruar një peticion adresuar kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, për ta vënë në dijeni të situatës në të cilën ndodhen. "Në datën 15 nëntor 2017, ne vendosëm që t'i dërgonim një peticion kryebashkiakut Veliaj në lidhje me kushtet skandaloze në të cilat ndodhet kjo rrugë. Është gjithë gropa, e sot me reshjet e dendura të shiut, është mbytur nga balta e uji. Nuk kalojmë dot",- shprehet një prej banorëve për "GSH". Ndërkaq, ata bëjnë me dije se në zonën ku jetojnë, përfshihet edhe rruga "Azbi Serani", në të cilën po zbatohet një projekt për rehabilitimin e strukturimin e plotë të rrugëve, dhe sipas tyre rrugica "Qamil Buxheli" është pjesë e saj dhe normalisht duhet të jetë pjesë e projektit. "Në zonën tonë, ku përfshihet rruga "Azbi Serani", është duke u zbatuar një projekt i investuar nga Bashkia e Tiranës me vlerë disa qindra milionë lekë, për rehabilitimin dhe ristrukturimin e plotë, të rrugëve kryesore dhe të gjitha rrugicave, për zgjerimin e tyre, ndërtimin e trotuareve, asfaltimin e plotë, ndërtimin e kanalizimeve me projekt bashkëkohor, ndërtim të mureve rrethuese për çdo banesë dhe i kangjellave të oborreve për çdo shtëpi. Rrugica "Qamil Buxheli", banorë të së cilës ne jemi, është njëra nga rrugicat që lidhet me projektin kryesor, pra me rrugën kryesore "Azbi Serani",-citohet në peticionin e banorëve drejtuar Bashkisë së Tiranës. Ndërkaq një banor tjetër i kësaj rruge shprehet i shqetësuar dhe kërkon një përgjigje nga kryebashkiaku, pasi sipas tij është e padrejtë që mos të përfshihen në projekt vetëm 60 metra rrugë. "Më vjen keq që është vepruar në këtë mënyrë me ne, nuk arrijmë të kuptojmë se përse nuk jemi përfshirë në projekt, kur është vetëm një segment i vogël rruge, por që prek rreth 50 banorë që kalojnë aty përditë. Me këto kushte klimaterike, rruga ka dalë jashtë funksionit dhe ne na duhet të mbyllemi në shtëpi pasi me zor kalojmë. Edhe ne jemi taksa pagues të rregullt si gjithë të tjerët dhe meritojmë të jetojmë në kushte të mira, të kalojmë në një rrugë të ndriçuar e të rregulluar",-tregon për "Gazeta Shqiptare", një prej kryefamiljarëve të rrugës "Qamil Buxheli". Banorët njëzëri kërkojnë rregullimin e rrugës pasi sheshi para shtëpive të tyre prej kohësh është shndërruar në një "kënetë" plot me ujëra të zeza, për mungesë kanalizimesh. Ata bëjnë thirrje për ndihmë pasi kjo rrugë është kthyer në një vatër infeksioni që rrezikon shëndetin e tyre. "Sheshi shtrihet përpara banesave tona në një gjatësi prej 50-60 metrash, aq sa është edhe gjatësia e rrugës. Ky shesh në 12 muaj që ka viti është i mbushur me ujëra të bardha dhe të zeza, sepse nuk ka kanalizime. Me plot kuptimin e fjalës mund të quhet një kënetë e vogël në qoshe të Tiranës ku gjatë gjithë vitit ka ujëra të pista, bretkosa, mushkonja, e kjo mund të jetë një burim infeksionesh dhe përbën rrezik për komunitetin."-thuhet më tej në peticion. Një tjetër banor i zonës tregon për "GSH" se peticioni i tyre ka mbërritur në Bashki pasi kanë marrë njoftim nga posta. "Ne e dimë që letra jonë ka arritur në Bashkinë e Tiranës, sepse u njoftuam nga posta në lidhje me këtë, por kanë kaluar 15 ditë dhe ne ende nuk kemi marrë një përgjigje sesi do të vejë fati i kësaj rruge dhe i komunitetit që preket. Po bëjmë veprime të paligjshme e të panderşme në kurrizin tonë dhe ne e quajmë gjithë këtë një mungesë vëmendjeje nga ana e përgjegjësve",- thotë për "GSH" një tjetër banor i zonës.



Rruga "Qamil Buxheli"



LETËR E HAPUR

**Drejtuar: Kryetarit te Bashkise Tirane**

**Zotit Erion Veliaj**

I nderuar Zoti Kryetar i Bashkise,

Qe me daten 15.11.2017, ne banoret e rruges "Qamil Buxheli", pranjë ish-kombinatit "Misto Mam" në Tiranë, ju jemi drejtuar personalisht juve me nje peticion. Peticioni eshte marre nga ana juaj sipas shkresave qe na kane ardhur nga posta por edhe pse kane kaluar me shume se 10 ditë, nuk kemi marre asnje perjigje lidhur me shqetesimin tejet serioz që ne ju kemi parashtruar. Ky eshte edhe shkaku qe u detyruam qe t'iu drejtohemi me kete leter te hapur.

Perserisim se, ne qe u adresuam tek ju si Kryetar Bashkie me ane te peticionit te dates 15.11.2017, dhe qe po ju sërisht me kete leter publike, jemi banoret e e Rruges "Qamil Buxheli", njesia adminsitrative Nr.6, Kombinat, me vendndodhje "Fusha Misto Mame", Tiranë.

Ne zonen tone, ku perfshihet rruga "Azbi Serani", eshte duke u zbatuar nje projekt i investuar nga Bashkia e Tiranes me vlerë disa qindra million lekë, per rehabilitimin dhe ristrukturimin e plotë, te rrugeve kryesore dhe te gjitha rrugicave, per zgjerimin e tyre, ndertimin e trotuareve, asfaltimin e plot, ndertimin e kanalizimeve me projekt bashkekohor, ndertim te mureve rrethuese per cdo banese dhe i kangjellave te oborreve per cdo shtepi.

Rrugica "Qamil Buxheli", banore te te ciles ne jemi, eshte njera nga rrugicat qe lidhet me projektin kryesor, pra me rrugen kryesore "Azbi Serani".

Me keqardhje konstatojme se rrugica "Qamil Buxheli" sipas projektit por edhe sipas zbatimit qe po behet ne fakt, deri ne gjysmen e saj ne nje gjatesi prej gati 50 metrash, eshte perfshire ne projekt dhe po punohet aktualisht per reabilitimin e saj,

**REAGIMI I BANORIT**

"Më vjen keq që është vepruar në këtë mënyrë me ne, nuk arrijmë të kuptojmë se përse nuk jemi përfshirë në projekt, kur është vetëm një segment i vogël rruge, por që prek rreth 50 banorë që kalojnë aty përditë. Me këto kushte klimaterike, rruga ka dalë jashtë funksionit dhe ne na duhet të mbyllemi në shtëpi pasi me zor kalojmë."

**PETICIONI**

"Sheshi shtrihet përpara banesave tona në një gjatësi prej 50-60 metrash, aq sa është edhe gjatësia e rrugës. Ky shesh në 12 muaj që ka viti është i mbushur me ujëra të bardha dhe të zeza, sepse nuk ka kanalizime. Me plot kuptimin e fjalës mund të quhet një kënetë e vogël në qoshe të Tiranës."

**STATISTIKAT**



## 1 pensionist në 4 nuk merr pension, vendi ynë larg standardeve europiane

Në vendin tonë, 1 në 4 individë që janë në moshë pensioni, nuk arrijnë të marrin asnjë kontribut monetar. Sipas të dhënave më të fundit të publikuara në raportin e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ILO, në Shqipëri, marrin pension vetëm 77% e kësaj kategorie, ndërsa pjesa tjetër, realisht nuk përfiton asgjë. Këto shifra tregojnë edhe njëherë se vendi ynë nuk i plotëson standardet dhe madje është larg të qenit një shtet i mirëqenies sociale. Fakti që jo çdokush që është në moshë pensioni, nuk e përfiton një të tillë, e rendit Shqipërinë larg Europës Perëndimore. Gjithsesi, në lidhje me këtë çështje, vendi ynë rezulton me performancën më të mirë në rajon, duke i lënë pas të gjitha shtetet fqinje. I vetmi vend rajonal që paraqitet më mirë se ne, është Greqia, e cila kap normën 77.4%, pra 0.4% më lart. Pavarësisht kësaj, mesatarja e Europës dhe Azisë Qendrore ndërkohë fiksohet në 95.2%. Por, Organizata Ndërkombëtare e Punës, ILO, në bazë të raportit që ka publikuar, jep alarmin për Shqipërinë edhe mbi asistencën sociale pasi vetëm 6.9% e të papunëve marrin pagesë monetare për shkak të situatës ekonomike që paraqesin. Të gjitha këto shifra tregojnë se Shqipëria renditet shumë larg shteteve të mirëqenies sociale.


BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET
INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID
BalkanWeb.com
BW
FALAS

## DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targat

# Amnistia për makinat, afati deri në 31 dhjetor

## Janë 140 mijë automjete që përftojnë nga falja

Ornela Manjani

Drejtoria e Shërbimet të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të pashlyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfituar nga amnistia. Zbatimi i ligjit "Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore", ka hyrë në një fazë të rëndësishme. Kështu thotë në një njoftim të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, ku theksohen se procedurat mund të ndiqen deri më datë 31 dhjetor 2017. "Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfitojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/ shuarjes së detyrimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligjit 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet/personat përgjegjës të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

**FSHIRJA E DETYRIMEVE**

Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhen me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota", thuhet në njoftim DPSHTRR.

### TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIME TË PASHLYERA

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TARGA | TR7838K | TR786D | TR7904E | TR7933R | TR7968P | TR8004K | TR8040J | TR8079D | TR8122D | TR8159N | TR8200J |
| | TR7838L | TR786E | TR7905R | TR7934J | TR7969F | TR8005F | TR8041D | TR8079G | TR8123C | TR815G | TR8200P |
| TR7803I | TR7839I | TR7870G | TR7906K | TR7935S | TR7969I | TR8005G | TR8042E | TR8079L | TR8124G | TR8163L | TR8202L |
| TR7803K | TR7839K | TR7870K | TR7907D | TR7935U | TR7969U | TR8005I | TR8044D | TR8079R | TR8124H | TR8165F | TR8202S |
| TR7803L | TR7839R | TR7871H | TR7907P | TR7936S | TR796D | TR8006T | TR8044I | TR807G | TR8124I | TR8165J | TR8203F |
| TR7805J | TR783D | TR7872G | TR7908K | TR7938F | TR796E | TR8008K | TR8044N | TR8080D | TR8125C | TR8166I | TR8204P |
| TR7808L | TR783E | TR7872J | TR7908L | TR7939F | TR796F | TR8009G | TR8049C | TR8081L | TR8125N | TR8166K | TR8204T |
| TR7809D | TR783F | TR7873F | TR7908M | TR7939J | TR7970G | TR8009L | TR8049J | TR8082C | TR8126F | TR8166R | TR8205L |
| TR7809E | TR783H | TR7873G | TR7908P | TR793G | TR7970I | TR8011J | TR8049K | TR8082D | TR8127K | TR8167G | TR8207A |
| TR7809H | TR7840E | TR7873R | TR790D | TR7940B | TR7970K | TR8011R | TR8049L | TR8082J | TR8127M | TR8169J | TR8207D |
| TR780D | TR7840H | TR7874G | TR790E | TR7940K | TR7972I | TR8012E | TR804F | TR8082M | TR8128D | TR8169K | TR8207G |
| TR780E | TR7840I | TR7874J | TR790F | TR7940L | TR7974B | TR8012I | TR804G | TR8083D | TR8128I | TR8169M | TR8208A |
| TR7810K | TR7840L | TR7874R | TR7911D | TR7941D | TR7974E | TR8014F | TR8050D | TR8083K | TR8128J | TR816E | TR8208E |
| TR7811E | TR7841M | TR7876H | TR7911S | TR7941H | TR7974I | TR8014G | TR8050I | TR8083L | TR8128P | TR8170G | TR8208L |
| TR7811K | TR7842I | TR7878F | TR7912L | TR7941J | TR7974N | TR8015A | TR8050K | TR8084D | TR8129A | TR8170I | TR8210G |
| TR7811N | TR7842L | TR7878L | TR7912N | TR7942N | TR7977B | TR8015D | TR8051F | TR8084G | TR8129J | TR8172E | TR8212E |
| TR7812M | TR7842M | TR7879J | TR7912S | TR7943D | TR7977L | TR8016F | TR8051K | TR8085C | TR812F | TR8172L | TR8213G |
| TR7813F | TR7844E | TR787G | TR7913I | TR7943P | TR7977N | TR8016P | TR8051M | TR8085E | TR8130A | TR8172M | TR8213K |
| TR7813I | TR7844J | TR7881H | TR7914M | TR7944P | TR7978J | TR8017B | TR8053B | TR8085L | TR8130R | TR8173M | TR8214D |
| TR7814G | TR7845J | TR7881T | TR7915E | TR7945E | TR7978S | TR8018A | TR8053E | TR8085N | TR8131K | TR8173P | TR8215S |
| TR7814S | TR7845K | TR7882N | TR7915N | TR7945L | TR797C | TR8018G | TR8053J | TR8086G | TR8131L | TR8174R | TR8216L |
| TR7816E | TR7846D | TR7883E | TR7915S | TR7945T | TR7980N | TR8018L | TR8053K | TR8087M | TR8134J | TR8175E | TR8216M |
| TR7816J | TR7846L | TR7883S | TR7916S | TR7946J | TR7980R | TR8018M | TR8054D | TR8088H | TR8134P | TR8176J | TR8216R |
| TR7817F | TR7847J | TR7884E | TR7917M | TR7947J | TR7980T | TR8019K | TR8054G | TR8088N | TR8137I | TR8177K | TR8218N |
| TR7817K | TR7847K | TR7884H | TR7919N | TR7948F | TR7981H | TR8019N | TR8055I | TR8089A | TR8138I | TR8177L | TR8218S |
| TR7817L | TR7849F | TR7884K | TR7919R | TR7948J | TR7981P | TR8019R | TR8055J | TR8090L | TR8138L | TR8177R | TR821BTX |
| TR7817N | TR7849J | TR7885C | TR7920D | TR7948K | TR7982H | TR801D | TR8056R | TR8091F | TR8139F | TR8178I | TR821F |
| TR7818K | TR7849K | TR7885E | TR7920K | TR7949L | TR7982N | TR801E | TR8057G | TR8092J | TR813C | TR8178N | TR8220P |
| TR7818L | TR7849N | TR7885K | TR7920L | TR7949R | TR7983I | TR8022G | TR8057K | TR8093K | TR813F | TR8178R | TR8220R |
| TR7818N | TR7849S | TR7886F | TR7920P | TR794D | TR7983K | TR8022N | TR8058J | TR8093M | TR8140E | TR8179L | TR8221F |
| TR7819C | TR784G | TR7886G | TR7921F | TR794E | TR7985K | TR8023E | TR8058K | TR8093P | TR8140F | TR8179R | TR8221K |
| TR7819L | TR7850G | TR7887H | TR7921M | TR7951D | TR7987L | TR8023M | TR8059K | TR8095F | TR8140N | TR817D | TR8221M |
| TR781D | TR7850I | TR7887K | TR7922F | TR7951N | TR7987T | TR8024D | TR805E | TR8095K | TR8142G | TR817E | TR8221P |
| TR781E | TR7850K | TR7889F | TR7922G | TR7952F | TR7988F | TR8024H | TR805F | TR8095N | TR8143N | TR817F | TR8221R |
| TR781G | TR7851K | TR788C | TR7922K | TR7952L | TR7988G | TR8024I | TR8060E | TR8096G | TR8143R | TR8180B | TR8222D |
| TR7820D | TR7853C | TR788F | TR7922T | TR7952U | TR7988K | TR8024L | TR8062J | TR8097F | TR8144L | TR8180F | TR8222I |
| TR7820N | TR7853K | TR7890F | TR7923C | TR7953I | TR7988P | TR8025F | TR8062K | TR8097H | TR8145G | TR8180K | TR8223B |
| TR7821F | TR7854J | TR7890G | TR7923G | TR7954D | TR7988U | TR8026F | TR8063G | TR8097J | TR8145H | TR8180T | TR8223E |
| TR7821K | TR7854K | TR7890M | TR7923J | TR7954S | TR7989I | TR8026K | TR8063L | TR8099I | TR8145L | TR8182J | TR8225J |
| TR7821R | TR7855J | TR7890R | TR7924E | TR7956J | TR7989K | TR8026R | TR8064I | TR809B | TR8146K | TR8182K | TR8225K |
| TR7822I | TR7857K | TR7891G | TR7925B | TR7957C | TR798A | TR8027J | TR8064L | TR809D | TR8146N | TR8183T | TR8226L |
| TR7822K | TR7858B | TR7891T | TR7925D | TR7957K | TR7990I | TR8027M | TR8066P | TR809F | TR8147B | TR8184J | TR8227F |
| TR7824M | TR7859I | TR7892H | TR7925G | TR7957M | TR7990J | TR8027N | TR8067D | TR8101B | TR8147J | TR8186E | TR8228I |
| TR7825S | TR7859K | TR7893F | TR7925M | TR7957P | TR7990M | TR8028C | TR8067N | TR8103H | TR8147P | TR8187L | TR8229F |
| TR7826H | TR7859R | TR7894F | TR7926C | TR7957R | TR7990N | TR8028H | TR8068E | TR8103M | TR8148D | TR8188E | TR8229P |
| TR7826I | TR785D | TR7895F | TR7926I | TR7958J | TR7992J | TR8028J | TR8068G | TR8107J | TR8148J | TR8188H | TR822E |
| TR7826P | TR7860C | TR7895I | TR7927F | TR7959K | TR7992R | TR8029T | TR8068H | TR8108G | TR8148L | TR8188K | TR8231H |
| TR7827E | TR7861L | TR7896J | TR7927J | TR795BTX | TR7993H | TR802D | TR8069I | TR8108J | TR8148M | TR8189G | TR8232H |
| TR7827K | TR7861S | TR7896K | TR7927K | TR7960M | TR7993T | TR8030C | TR806D | TR810C | TR8149I | TR8189M | TR8233J |
| TR7828E | TR7862L | TR7896L | TR7927P | TR7961J | TR7994A | TR8030K | | TR810F | TR8149L | TR818E | TR8235G |
| TR7828I | TR7862M | TR7897H | TR7928F | TR7961R | TR7994J | TR8030R | TR8070H | TR8110M | TR8150R | TR8192P | TR8235J |
| TR7828R | TR7862N | TR7897I | TR7928K | TR7962K | TR7994N | TR8031F | TR8070J | TR8111E | TR8151G | TR8192R | TR8235L |
| TR7829G | TR7863N | TR7897N | TR7929N | TR7962N | TR7994S | TR8032E | TR8071F | TR8111H | TR8151J | TR8193B | TR8236D |
| TR7830C | TR7863P | TR7898P | TR792E | TR7963I | TR7995I | TR8032P | TR8071K | TR8111N | TR8153P | TR8193L | TR8236L |
| TR7830P | TR7864J | TR7899F | TR792F | TR7963K | TR7996L | TR8032S | TR8071T | TR8114I | TR8154R | TR8195P | TR8237J |
| TR7830S | TR7864N | TR7899G | TR7930F | TR7964E | TR7997A | TR8033D | TR8072C | TR8114L | TR8156A | TR8195R | TR8238G |
| TR7832E | TR7865L | TR7899I | TR7930I | TR7964F | TR7998E | TR8033E | TR8073A | TR8114S | TR8156U | TR8196B | TR8238M |
| TR7833E | TR7866E | TR7900J | TR7930J | TR7964L | TR7998J | TR8033R | TR8073H | TR8115D | TR8157F | TR8196C | TR8239L |
| TR7833G | TR7866K | TR7900P | TR7930L | TR7964M | TR7999B | TR8034H | TR8074G | TR8116J | TR8157H | TR8196F | TR823E |
| TR7833K | TR7867A | TR7900T | TR7931G | TR7964N | TR799D | TR8034J | TR8074H | TR8117M | TR8157K | TR8196L | TR823F |
| TR7834K | TR7867C | TR7901K | TR7931H | TR7965C | TR799F | TR8035J | TR8075C | TR8118B | TR8158F | TR8198J | TR8240G |
| TR7835G | TR7868E | TR7901L | TR7932I | TR7967F | TR8002I | TR8036B | TR8076K | TR811G | TR8158H | TR8198R | TR8240H |
| TR7835I | TR7868N | TR7902J | TR7932L | TR7967P | TR8002R | TR8036J | TR8076R | TR8120A | TR8158J | TR819E | TR8241L |
| TR7837J | TR7869C | TR7902L | TR7933H | TR7968F | TR8003F | TR8037E | TR8077M | TR8120J | TR8159H | TR819F | TR8241N |
| TR7838H | TR786A | TR7903S | TR7933L | TR7968H | TR8003K | TR803F | TR8078H | TR8120S | TR8159J | TR8200C | TR8241S |

FILMI

Rishfaqja e një filmi bashkon kineastët në Natën e Bardhë. 15 vite më parë, ishin më shumë. Mes mungesave, një film i rëndë, që të sjell ndër mend pezmin e Tarkvoskit, shfaqet në ekranin e madh

# “LULE TË KUQE, LULE TË ZEZA” Shanaj e Lako: Një film për ata që nuk na kthyen shpinën

Fatmira Nikolli

*Yllka Mujo: Muzika e fundit e Kujtim Laros, më tha kam shkruar muzikën e vdekjes sime*

15 vite nga koha kur në një fshat në jug, një grup kineastësh xhiroi një film, në një qoshe të kryeqytetit të zhurmshëm të Natës së Bardhë, një sallë pranë Kinostudios, vendos ta risjellë për publikun. Mungojnë tre veta: Kujtim Laro, Bujar Lako e Gent Demaliaj. Por filmi është edhe për ata “Lule të kuqe, lule të zeza”.

Pesha e rëndë e një jete gri, në një fshat që mban mbi supe mjegulla të pakoha, njerëzish që ikin e njerëzish që rrinë, përbën fillin lidhës të filmit “Lule të kuqe, lule të zeza”. I xhiruar në fillim të viteve 2000, por me ndikimin e fortë të 1997-ës, filmi shpërfaq jetët e zbrazëta që sillen rreth Lilianës(Yllka Mujo)- një grua e fortë dhe e brishtë, pothuaj e çmendur e njëherësh krejt e kthjellët, që bart si mallkim kobe rreth vetes. Fshati është përbashkuesi i jetëve të ngelura aty, mësuesi a Sfinksi (Mevlan Shanaj), taksisti i çartur (Bujar Lako), një banor jo fort i zakonshëm (Vasian Lami) një prift që vjen (Kastriot Çaushi), vajzën e bukur të Lilianës, Ana Pashanë(Elia Zaharia) dhe të atin, një burrë që është ndjerë gjithherë i pafuqishëm (Enver Petrovci). Një burrë që ikën, një dhëndër që zhduket, nënë e bijë që goditen deri në mavijosje, një prift e një hoxhë të dyshimtë që nuk munden të ngjallin as shpresë, as besim e as ringjallje, një tregtar skeletesh, dhe një tank i madh, një tank që kërcënon të marrë përpara çdo gjë. Po ç'mund të marrë para në një fshat që nuk ka mbetur asgjë? Një fshat që ruan mes merimangash, kujtime e atyre që ikën, që e lanë, një fshat i syrgjynosur në kujtesë të fshehura.

Elia Zaharia, Yllka Mujo, Enver Petrovci, Bujar Lako, Kastriot Caushi, Petrit Malaj, Vasjan Lami, Kled Kapexhiu janë banorët e fundit para ‘apokalipsit’.

Skenari është i ‘grande damës së vargjeve’, Natasha Lakos. Gjen paralele mes “Kundërpërfytyrimit” të saj dhe jetëve që ka ravijëzuar në personazhet e pa histori që bashkohen në një gjysmë dritë që i ndjek deri në çastin e mbramë. Ai fshat që mbajti jetët tona, mban varur një qen, e diku matanë, mban të vdekurit tanë. Larg prej këtej janë të ikurit, këtu, jemi ne të mbeturit, me dramat që na mbajtën lidhur dhe kujtimet që na kanë burgosur.

Skenat janë të fuqishme dhe një kamera e pastër (e Afrim Spahiut) në mjegullën që mbulon çdo gjë, kap detaje që shpesh janë më domethënëse se plani i parë. Skenat janë të rënda, qofshin të dashurisë, qofshin të vdekjes. Duket sikur i marri i Tarkovskit ka marrë në dorë narracionin e një absurditeti ku dhimbja njerëzore mban mbërthyer personazhet e ‘luleve’. Siç parathotë titulli, Mevlan Shanaj që mban në duar regjinë, portretizon një kontrast të thellë mes atyre që ikën e atyre që mbeten, me kthimet që s'kanë dobi, që janë kaq të vona. E pyes, pse vdiq Ana, por nuk marr përgjigje. Pezmi nuk del, por ndjehet. Pikëpyetjet shumëfishohen, ndërsa kolona zanore e Kujtim Laros, si një marsh funebër, të mban në trysninë e frikës. Është një film autor. Veprimet janë të thjeshta. Dialogët po ashtu. Është thellësia e secilit mendim a veprim, që ia jep peshën. Si dialogu i fundmë i Yllkës me Mevlanin, dy mësuesve që patën pritur kaq gjatë në atë burg të madh.

“Një komunitet njerëzor pa gjeografi dhe identitet, vijë ndarëse midis gjendjes primitive dhe qytetërimit, pamje të një shkatërrimi të përgjithshëm dhe makthi i asgjësimit të jetës, humbja dhe shpresa për ringjallje, përbëjnë metaforën e skajit të së keqes, si një rrezik dhe paralajmërim për të mos arritur gjer atje. “Lule të kuqe, lule të zeza” i Mevlan Shanajt, episod pas episodi, na fut në meditimin për të shpjeguar një shoqëri në apokalips, si Shqipëria e vitit 1997, ku një pjesë e katastrofës shpirtërore shpjegohet me përçarjen e pjesës së ndritur dhe pjesës së errët të njeriut”,-pat shkruar Vath Koreshi.

Për Yllka Mujon, filmi është një vepër komplekse. “Është gri. Është ndërthurje emocionesh”. Kujton kur Kujtim Laro i dhuroi diskun me muzikën e filmit. “Më tha që më duket se kam shkruar muzikën e vdekjes sime. Ajo qe e fundit që shkroi”,-tha Yllka Mujo, të mërkurën në mbrëmje kur filmi u shfaq pas 15 vitesh në kinemanë e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit. “Jam e lumtur jashtëzakonisht që kam pasur një rol të tillë më kinema. Është pak haluçinativ. Ne jetuam në atë vend. U bënë pjesë e jona. Aty shëtisnim, shihnim çdo gjë, aty jetuam dhe u bëmë njësh me të”.

Kur fjalën e mori Shanaj, në fillim kërkoi falje. “Ju kërkoj falje se mund të keni ardhur për t'u kënaqur. Nuk është film për t'u kënaqur, është një film që të meditoni, sepse keni parë dramën e familjes e të shoqërisë me muzikën e Laros”.



Mevlan Shanaj dhe Natasha lako



Mevlan Shanaj dhe Yllka Mujo në filmin “Lule të kuqe, lule të zeza”

### NATASHA LAKO: NJË PROGNOZË, NJË KËNGË PËR ATA QË QËNDRUAN

Poetja kujton kur kthehej nga Suedia pas 1997-ës. “Ne u kthyem. Të vetmit që vendosëm të ktheheshim. Ne jemi ata që qëndruam. Filmi është për ne që qëndruam”,-tha ajo, mes emocionesh. Përballej pas kaq vitesh me filmin e saj. 20 vite më pas, nuk duket se ka ndryshuar shumëgjë. Shqipëria vijon të boshatiset, si fshati i filmit të saj. Atëkohë, kur kthehej, trauma e saj e parë ishte Shqipëria e shkatërruar.

**-Si e kujtoni procesin e punës për skenarin?**

Në fillim dua të them se ka një prognozë filmi. Është një prognozë që përsëritet herë pas here në Shqipëri, për ikjet e shqiptarëve. Kohët e fundit OKB-ja ka parashikuar që pas 30 vitesh shqiptarët do të mbeten 1 milionë e 700 mijë. Filmi e ka thënë këtë prognozë që nga viti 1999, kur është shkruar, sepse ishte vala e ikjeve sidomos pas ngjarjeve të 1997-ës. Megjithatë, nuk duhet të trembemi tani. Është thjesht një dokument, nuk mendoj vërtetë se do të zvogëlohet Shqipëria. Filmi nuk dihet gjithnjë se ku e ka ngacmimin e parë, por një ngacmues, ka qenë edhe djali ynë Joni Shanaj, sepse në atë kohë ai ka qenë student në Suedi. Ishte një ngacmim për ata njerëz që rezistojnë e mbeten këtu. Ka disa tema, ka tema për të ikurit e ka tema për ata që qëndrojnë, që vendosin të punojnë e të jetojnë me të gjithë traumat, me të gjithë kujtimet e trishtimet e tyre personale në këtë vend. Për ata është filmi, për ata që nuk shkulen nga ky vend. Mbase për njerëz si puna jonë.

**-A është filmi për trishtimin e ditëve tona?**

Jo, sepse ditët kanë edhe bukuritë e tyre. Ishte një marrëdhënie e tillë njerëzore atë periudhë. Ju e dini që në atë kohë gazetat shkruanin që kushdo merrte një tank dhe udhëtonte me të. E bënte taksi. Gjer në këtë absurditet mbërrinte pas 1997-a. Ka diçka nga ky absurditet, por në radhë të parë ka absurditetin e marrëdhënieve shumë të thella njerëzore. Pa marrëdhënie të thella njerëzore nuk mbetesh këtu, është mendimi im kryesor.

**-Pse e mori titullin “Lule të kuqe, lule të zeza”?**

Ka të bëjë me disa kujtime familjare. E kishim këtë si një kredo të familjes sonë, me një këngë femïnore dhe e shfrytëzuam për filmin, sepse shqiptarët e kanë të kuqen e të zezën, edhe si kontrast.

**-E menduat që kur shkruat ske-**





**narin se do ia besonit regjinë bashkëshortit tuaj?**

Po, me thënë të drejtën. Unë kam bërë skenarin e 14 filmave artistikë me metrazh të gjatë. Ishte hera e parë që, prej momentit kur shkrova skenarin, mendova për rolin e Mevlanit e të Yllkës. Herë e parë që kur shkrova skenarin u mbështeta edhe në karakterin e aktorit.




**-Si u bë i mundur xhirimi në atë kohë, kur ende Shqipëria nuk e kish marrë veten nga '97-a?**

Ndoshta për shumë njerëz është e pabesueshme, mundimi i jo vetëm i kineastëve shqiptarë, por i çdo kineasti për të xhiruar; jo pse ishte '97-a, një kineast nuk ka '97-ë kur xhiron, por përpjekja është e jashtëzakonshme.

-Ju ka rënduar shpirtërisht të shkruarit e skenarit?

Në kinema shihet ndryshe. E shoh ndryshe tani, si spektatore.

## MEVLAN SHANAJ: PËR DASHURINË PËR FILMIN, E ATA QË NA MUNGOJNË

Kineasti Mevlan Shanaj e ka këtë filmin e disatë. Mes regjisë e personazhit, shpërthimet e tij i ngjajnë rrebesheve të dhembjes. Një burrë, një burrë si ai, i vetëm, i lënë në një fshat ku nuk shkel më asnjë këmbë. Përtej personazhit që bart të mirën e të keqen, Shanaj, ka mbi supe edhe peshën e regjisë, që vite më vonë duket se nuk e ndjen më.

**- A janë njerëzit që qëndrojnë këtu, "Lulet e kuqe, lulet e zeza"?**

Është pyetje e vështirë kjo. Di të them se "Lulet e kuqe, lulet e zeza" është 15- vjeçar. Në kinema 15 nuk janë keq, mirë është të shkojë deri në 100, por ky rikthim i filmit sot në ekran, në këtë datë të bukur festë të Natës së Bardhë, më jep një kënaqësi. Kënaqësi për ta parë edhe njëherë në ekran të madh, sepse vërtetë u bënë shumë vite, e për të parë reagimin e tyre që se kanë parë. Në kohën kur ka ardhur ka qenë një film që ka provokuar. Jam ndjerë mirë, e çdo gjë që provokon, sjell një farë mendimi. Kur filmi mbaron, nuk vijon biseda, por ecin dhe meditojnë, qëndrojnë të heshtur, bëjnë disa hapa duke folur me veten e tyre. Kjo ka qenë kënaqësia ime te "Lule të kuqe, lule të zeza". Unë e kam përjetuar këtë lloj meditimi të shikuesve, por, nga ana tjetër, kam punuar me një staf të shkëlqyer.

**-Jeni sërish në ekran me Yllkën...**

Po, me partneren time të hershme që nga viti 1969-1970, te "I teti në bronz".

**-Ka mungesa sonte, si është ta shohësh filmin pa ta?**

Ka mungesa, mungon Kujtim Laro që ka bërë në këtë film, muzikën e tij të fundit që është cilësuar si Enio Morikone i muzikës shqiptare; mungon Bujar Lako prapë ju të medias e keni quajtur gjenerali i ekranit shqiptar; mungon Gent Demaliaj, një talent i madh. Sonte vjen ky projeksion mes miqsh, por me tri mungesa shumë të mëdha.

**-Është një homazh për ta?**

Le ta quajmë kështu. Kur ata nuk janë, sigurisht njeriu të shkuarën e apelon brenda vetes, e kujton. Me kalimin e kohës e kujton me gropa, por kujtime të tilla të këtyre monumenteve që i ke pasur bashkudhëtarë nuk harrohen kurrë. Unë nuk di se ç'do të ndodhë nesër, as me mua as me kinemanë, por për këto vite që kemi kaluar ruaj me shumë dashuri e me shumë dashuri gjëra që kam dëshirë t'i përjetoj gjatë.

**-Si ka qenë bashkëpunimi me Natasha Lakon?**

Me Natashën unë kam shumë filma, një pjesë me mua, duke filluar që nga "Plumba perandorit", që është një film me firmën tonë rezistente prej 40 vitesh; ose "Fletë të bardha", i cili provokoi një ndjeshmëri deri në instancat më të larta, administratën e kohës e kemi marrë kënaqësi. Kur vijmë te "Lule të kuqe, lule të zeza" është një shikim pak më i çliruar. Shkojmë më shumë drejt natyrës së perceptimit të filozofisë së Natashës, siç është Natasha edhe në poezi, që duhet ta lexosh dy a tri herë që ta kuptosh. E pastaj befasohesh. Metafora e saj edhe në këtë film, është rezistente. Unë jam munduar ta kuptoj dhe mendoj se ka mbetur e kënaqur.

**-Natasha tha se për herë të parë i ka zgjedhur vetë dy aktorët që kur shkruante skenarin. Ju keni ndikuar tek ajo?**

Kam dy aktorë për të cilët kam lëvizur nga mendimi im bazë: kam lëvizur nga Vangjush Furrxhiu që për shkak të gjendjes shëndetësore u tërhoq dhe mora Enver Petrovcin. Është hera e parë që i jap vetes rol.

# Nga Bukureshti, për Pavarësinë

Dita Kombëtare e Shqipërisë është festuar edhe në Bukuresht. Me rastin e Ditës Kombëtare të Shqipërisë dhe pritjes së organizuar nga komuniteti shqiptar me këtë rast në Klubin Diplomatik në Bukuresht, u nderuan miq të mëdhenj të popullit shqiptar, akademiku Grigore Brancus, përkthyesi i mirënjohur dhe shkrimtari Marius Dobrescu dhe ambasadori Gheorghe Micu, të cilëve iu dha një Diplomë Nderi si dhe një Pllakë përvjetori për kontributin e tyre në promovimin e miqësisë dhe lidhjeve shqiptaro-rumune, por edhe në fushën e shkencës e kulturës. Të nderuarit miq të Shqipërisë morën urimet dhe mirënjohjen nga të gjithë pjesëmarrësit. Programi i festimit të Ditës së Flamurit përfshiu valle popullore shqiptare dhe një recital me këngë lirike qytetare shqiptare, të interpretuara profesionalisht nga artistja lirike Florentina Barbu dhe nga kitaristi Daniel Berteºteanu. Në këtë eveniment festiv morën pjesë Alin-Bogdan Stoica, deputet në parlamentin e Rumanisë dhe Radu-Cozmin Sãvulescu, kryetar i shoqatës ALAR. Morën pjesë, gjithashtu, personalitete të kulturës rumune me origjinë shqiptare, anëtarë të komunitetit shqiptar historik të Rumanisë, si shkrimtari dhe dramaturgu i shquar Vlad Zografi, trashëgimtar i familjes së Dhimitër Zografit, një nga nënshkruesit e Dokumentit të Pavarësisë, vajza e poetit të shquar me origjinë shqiptare Cezar Ivanescu, shkrimtari me origjinë shqiptare dhe arkeologu i mirënjohur Dr. Liviu Lungu, profesorja universitare me origjinë shqiptare, Daniela Bordea etj. Ishin të pranishëm edhe studiues e profesorë universitarë si albanologia Catalina Vatasescu, studiuesit Nicolae Saramandu, Manuela Nevaci etj. Aktivitetin e nderuan një numër i madh politikanësh, deputetë të parlamentit të Rumanisë, diplomatë, këshilltarë të Presidentit të Rumanisë, njerëz të kulturës, universitarë, gazetarë, miq e dashamirës të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Kanali kryesor TVR1, përgatiti një emision të posaçëm me rastin e Festës Kombëtare të Shqipërisë. Është për të ardhur keq se në këtë eveniment, organizuar nga komuniteti shqiptar i Rumanisë, nuk mori pjesë Ilir Tepelena, ambasadori i Shqipërisë në Rumani. Ky ambasador nuk ka munguar në veprimtari të tjera, me rëndësi të posaçme për kulturën dhe komunitetin shqiptar, siç janë promovimi i librit të poetes së mirënjohur shqiptare Rita Petro, simpoziumi kushtuar 70-vjetorit të vdekjes së Asdrenit, takimet me personalitete rumune, jeta dhe aktiviteti i të cilëve ka qenë ngushtësisht i lidhur me Shqipërinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare.

# Çmimi Letrar "Balkanika", përzgjidhen Bashkim Shehu e Luljeta Lleshanaku

Romani "Loja, shembja e qiellit", i shkrimtarit Bashkim Shehu është përzgjedhur nga juria kombëtare për t'u paraqitur në kompeticionin "Balkanika 2015". Për këtë roman shkrimtari Bashkim Shehu është shpallur fitues i çmimit "At Zef Pllumi" - 2013. Po këtë vit juria e Panairit të Librit Fier e nderoi me çmimin "Autor i Vitit" - 2013. Është hera e dytë që shkrimtari Bashkim Shehu, përzgjidhet për të konkurruar në këtë garë letrare ndërballkanike. Në vitin 2007 ai u paraqit me romanin "Angelus novus" dhe arriti të ishte një nga tre të nominuarit e këtij çmimi. Romani "Loja, shembja e qiellit" është botuar në shqip nga Shtëpia Botuese TOENA, në vitin 2013. Për këtë roman dhe vlerat e tij letrare janë shkruar me dhjetëra artikuj vlerësues në median e shkruar. Për t'u paraqitur në kompeticionin "Balkanika 2016", juria kombëtare përzgjodhi vëllimin me poezi "Homo Antarcticus" të poetes Luljeta Lleshanaku. Vëllimi poetik "Homo Antarcticus" është botuar në shqip nga Shtëpia Botuese OMBRA GVG në vitin 2015. Ky vëllim poetik ka marrë shumë vlerësime pozitive në median e shkruar.

Vëllimi poetik "Homo Antarcticus" i përkthyer në anglisht nga Ani Gjika si pjesë e vëllimit "Negative Space" ka fituar garën për mundësinë e financimit të përkthimit dhe të botimit në SHBA, si dhe çmimin letrar "PEN Translates" - 2017 në Britaninë e Madhe dhe, gjithashtu, mundësinë e botimit në Britaninë e Madhe gjatë pranverës të vitit të ardhshëm.

### ÇMIMI LETRAR 'BALKANIKA'

Çmimi Letrar Balkanika jepet nga Fondacioni Balkanika me qendër ekzekutive në Sofje të Bullgarisë. Anëtarë të këtij Fondacioni janë shtëpitë botuese: Biblioteka 48 (Bullgari), Toena (Shqipëri), Magor (FYROM), Kedros (Greqi), Laguna (Serbi), Can (Turqi), Muzeul National al Literaturii Romane (Rumani). Fituesit e edicionit të 17-të dhe të 18-të të këtij Çmimi shpallen të dielën, në 3 dhjetor 2017, nga Juria Ndërballkanike e këtij kompeticioni, në Qendrën Kulturore për të Rinj – Shkup. Më parë këtë Çmim e kanë marrë shkrimtarët shqiptarë Fatos Kongoli (2002) dhe Ismail Kadare (2009). Për Çmimin "Balkanika 2015", shkrimtari Bashkim Shehu është në garë me 6 autorë nga 6 vende të Ballkanit: Vladimir Yankovski "Invisible love" (FYROM); Christo Karastoyanov "The same night" (Bullgaria); Ana Ristovic "Directions for use" (Serbia); Seray ªahiner "The hairstyle of the bride" (Turqia); Dimosthenis Papamarkos "Gjak" (Greqia) dhe Simona Sora "Hotel Universal" (Rumania).

Për Çmimin "Balkanika 2016", poetja Luljeta Lleshanaku është në garë me 6 autorë të përzgjedhur nga 6 vende të Ballkanit: Lidija Dimkovska "Non-Oui" (FYROM); Nikolay Milchev "You and the cats in the afternoon" (Bullgaria); Vladan Matijevic "Very little light" (Serbia); Murat Özyaºar "Laugh yellow" (Turqia); Panagiotis Kechagias "Final warning" (Greqia) dhe Bogdan Teodorescu "Spada" (Rumania)

Opinioni i Ditës

# Për flamurin e 1 kombi dhe 2 qeveritë e tij

Nga Arian Galdini

*(vijon nga faqja 1)*

... bën që e gjithë paradigma e aspiratave tona kombëtare, por edhe e qeverisjes së drejtë, demokratike dhe në liri e me dinjitet të plotë njerëzor të shqiptarëve, të ndërtohet mbi themele të gabuara.

A jam unë nacionalist, në kuptimin e një idealisti dhe aktivisti që do kombin e tij përmbi gjithçka, e që urren a përçmon gjithkënd e gjithçka tjetër që është apo vjen nga kombe të tjera, sidomos ato fqinje?

Jo. Jo, dhe vetëm jo!

Jam kombëtarist që e dua kombin tim mbi gjithçka timen. Nuk urrej e as përçmoj askënd për shkak të dashurisë për kombin tim. Madje parimin e dinjitetit njerëzor e besoj të plotë për çdo qenie njerëzore në këtë planet.

Jam kombëtarist i rritur, mëkuar dhe ndërtuar vetëm nga arsyet e dashurisë, identitetit të qartë dhe motivimet e mbara të lartësimit të të drejtave dhe dinjitetit njerëzor.

Nuk ka në botë person, fuqi a interes që mund të ma lëkundë mua këtë ekzistencë si kombëtarist nga dashuria për kombin tim dhe njeriun si qënie.

Ndaj t'i rikthehemi arsyetimit parësor, duke mos lënë qime personale në duart e askujt që do të kërkojë ta rrjepë këtë reflektim publik.

Qeveria e Shqipërisë është pa diskutim qeveria më përfaqësuese e kombit shqiptar. Kjo nuk vjen për meritë të vetë qeverisë, por si rrjedhoje logjike e fakteve historike dhe gjeostrategjike.

Qeveria e Kosovës është qeveri me kryeministër e me shumicë dërrmuese e shqiptarëve, por i duhet të merret jo vetëm me punët e shqiptarëve, përpos atyre të pakicave që jetojnë atje.

Qeveria e Maqedonisë është qeveri me kryeministër sllavomaqedonas, shumicë sllavomaqedonase, e megjithatë ka edhe përbërje të ndjeshme të shqiptarëve. Kjo qeveri ka punë me sllavo-maqedonasit dhe shqiptarët kushtimisht, e nuk mund të anashkalojë pakicat e tjera.

Qeveria e Malit të Zi ka kryeministër dhe shumicë dërrmuese malazeze, ama e ka edhe një ministër shqiptar brenda saj e duhet të kujdeset normalisht edhe për rreth 7% të popullsisë së Malit të Zi, që është shqiptare.

Ndërkohë që qeveria e Greqisë ka veçantinë që edhe pse nuk ka asnjë shqiptar, së paku të njohur formalisht, si të tillë, ka shumë punë që e lidhin me shqiptarët që jetojnë atje si arvanitas, të padeklaruar, çamë ortodoksë, emigrantë, si edhe me pronat e pasuritë e shqiptarëve, përfshirë këtu edhe çështjen çame.

Ky parashtrim na ndihmon të kuptojmë se asnjë deklaratë e shitur si patriotike për kinse 1 komb me 2 qeveri, nuk është e tillë, pra nuk është në të vërtetë patriotike. Është aktoreske dhe patetike, ama kurrsesi patriotike.




Që 2 qeveri të bashkojnë një komb, u duhet të jenë përfaqësuese tërësore të këtij kombi.

Jemi të gjithë të qartë se qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës përfaqësojnë shumicën absolute të shqiptarëve, e për rrjedhojë kanë edhe detyrimin politik dhe institucional që të kujdesen e marrin vendime të forta për të gjithë shqiptarët kudo që ata ndodhen.

Që ta bëjnë këtë, u duhet të dyja qeverive që ndërsa punojnë e bashkërendohen për marrëveshjet dytësore, me karakter ndërshtetëror, të nisin projektimin e politikave të përbashkëta, të buruara e ndërlidhura me aspiratat tona kombëtare.

Janë shumë të domosdoshme edhe marrëveshjet ndërshtetërore, nëse zhvillohen dhe zbatohen përpikmërisht në kohën e kornizat sipas nënshkrimeve.

Sidoqoftë, që të mos rrezikojmë rënien në përdorim simbolikash dhe aktesh politike me sfond patriotik për arsye të politikave dhe marketingut ditor, ka rëndësi madhore të kërkohen dhe bashkërendohen projekte thelbësore me burim dhe qëllimësi, aspiratat tona kombëtare.

E di që do të më thonë se do bashkohemi kur të jemi pjesë e familjes europiane si anëtarë të BE me të drejta të plota.

Por nuk mund të rri pa iu përgjigjur atyre që thonë e mendojnë kësisoj: Po si mund të integrohemi pa u bashkuar? E nëse projekti i integrimit europian bëhet i gjatë, plot kthesa e të paditura, si mund të bashkohemi pa u integruar? A kemi ne si shqiptarë një projekt tonin, një axhendë tonën në njëfrekuencim me partnerët dhe aleatët tanë strategjikë SHBA, UK dhe BE, por edhe të përgatitur për çdo variabël të panjohur gjeostrategjik?



Opinioni i Ditës

# Fund vdekjeprurës dhe fije shprese

Vetëvrasja spektakolare e një të dënuari nuk e ul vlerën dhe rëndësinë e Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë, mendon Zoran Arbutina.

Nga Zoran Arbutina

*(vijon nga faqja 1)*

... ish-gjenerali i kroatëve të Bosnjës, Slobodan Praljak, thirri në sallë "Unë nuk jam kriminel lufte dhe e refuzoj dënimin", dhe piu helm nga një shishe e vogël që kishte me vete. Më pas ai vdiq në spital. Vetëvrasja ishte inskenuar në mënyrë perfekte. Praljaku që kishte tri diploma universiteti dhe kishte punuar disa kohë edhe si regjisor në TV dhe teatër, e piu helmin para kamerave - i sigurt se shumë vetë në Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë po e ndiqnin seancën drejtpërdrejt.

Dhe ai pati të drejtë, sepse mediet në Kroaci nisën garën se kush të lajmëronte e para për "vdekjen e një heroi kroat". Presidentja kroate si dhe ministrja e Jashtme ndërprenë udhëtimet jashtë vendit për t'u kthyer sa më shpejt në Kroaci. Kryeministri kroat deklaroi: "Ky akt dëshmon për padrejtësinë e lartë morale kundrejt kroatëve në Bosnje-Hercegovinë."

**RITUALE TË NJOHURA**

Natyrisht zemërimi ndaj Tribunalit të Hagës është i madh dhe flitet për paaftësi dhe padrejtësi, për komplot ndaj Kroacisë dhe kroatëve. Dhe pavarësisht prej vetëhelmimit tragjik dhe demonstrativ kemi të bëjmë me rituale të vjetra që i kemi përjetuar shpesh. Sapo gjyqtarët në Hagë shpallin një vendim, njëra palë e ndjen veten fituese, kurse tjetra vë në lëvizje makinerinë e zemërimit. Nuk ka rëndësi se cila palë, kroatët, serbët apo boshnjakët. Në Serbi theksohet se më tepër se të gjithë janë dënuar serbët, 1200 vjet heqje lirie dhe 4 vjet burgim të përjetshëm. Në Kroaci bëhet fjalë tani për një martir, i cili qe i gatshëm të vdiste për bindjet dhe popullin e tij.

Pa dyshim nuk është mirë që puna e Tribunalit të Hagës mbyllet me një ngjarje të tillë mediatike. Por kjo nuk është e pazakontë, sepse që në fillim të punës së saj në sallën e gjyqit ka pasur sulme nga vendet e ndryshme të ish-Jugosllavisë dhe skena skurile si ato të ish-presidentit serb Slobodan Miloševiæ.

**DRITË NË FUND TË TUNELIT?**

Megjithatë bilanci i Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë (ICTY) është kryesisht pozitiv. Gjatë 5 vjetëve u akuzuan 161 vetë, u morën në pyetje 4.600 dëshmitarë dhe u mblodhën 2,5 milionë dokumente. Në bankën e të akuzuarve ishin mjaft politikanë dhe ushtarakë të lartë si dhe drejtues grupesh ushtarake që nuk mendonin se do të dilnin ndonjëherë përpara drejtësisë. Edhe për viktimat kjo qe një mundësi për t'u përballur me dhunuesit.



Ky tribunal ka rëndësi të madhe edhe për zhvillimin e gjyqësisë ndërkombëtare. Për herë të parë Këshilli i Sigurimit të OKB-së vendosi që parimet e Kartës së OKB-së të mos realizohen me armë, por me rrugë ligjore. Për këtë gjyqtari gjerman Wolfgang Schomburg tha se kemi të bëjmë me një "hop quantik drejt rrugës për më tepër drejtësi."

> Ky tribunal ka rëndësi të madhe edhe për zhvillimin e gjyqësisë ndërkombëtare. Për herë të parë Këshilli i Sigurimit të OKB-së vendosi që parimet e Kartës së OKB-së të mos realizohen me armë, por me rrugë ligjore. Për këtë gjyqtari gjerman Wolfgang Schomburg tha se kemi të bëjmë me një "hop quantik drejt rrugës për më tepër drejtësi."

Tani popujt e ish-Jugosllavisë kanë më shumë mundësi për t'u përballur me të kaluarën dhe për t'u pajtuar. Ky potencial deri tani nuk është shfrytëzuar. Sidomos elitat politike ngulin këmbë te simbolet e armikut, sepse prej tyre përfitojnë. Me vetëhelmimin e tij spektakolar dhe mediatik Slobodan Praljak dha kontributin e vet për këtë. Ky nuk qe gabim. Por, kur të marrë fund turfullimi, ndoshta do të jetë e mundur bashkëjetesa në paqe dhe një perspektivë për të ardhmen. Këtë ua urojmë të gjithëve.

## HOROSKOPI

**DASHI**

Do të keni prirje për t'u mbyllur brenda vetes për të rrëmuar në të kaluarën. Por do të merrni në konsideratë edhe mundësinë e së tashmes. Kontakti me persona të veçantë do t'ju hapë horizonte të reja dhe do t'ju japë mundësinë të përmirësoheni.

**DEMI**

Me ndikimin e Jupiterit mik do të dini të menaxhoni një çështje të ndërlikuar në punë. Do të dilni fitimtarë si edhe me një mundësi të mirë për të ardhmen. Dëshira juaj për ëmbëlsi dhe dialog do të kuptohet menjëherë nga partneri.

**BINJAKET**

Plutoni ndodhet në qiellin tuaj dhe shfaq mirëkuptim me Hënën që në punë të zhbllokohet situata. Rezultatet nuk do të vonojnë. Disa persona ju bëjnë të ëndërroni për aventura, por nuk jeni të sigurt nëse bëjnë për ju.

**GAFORJA**

Mos u gënjeni nga shkëlqimi i një momenti pasioni që bën që t'ju rrahë fort zemra, sepse mund të dalë se është krejt ndryshe nga sa dukej. Pozicioni i Hënës me Saturnin në qiellin tuaj bën që të keni pak dëshirë të angazhoheni. Përpiquni të jeni më i gatshëm.

**LUANI**

Do të kaloni pengesat dhe do t'ia dilni më në fund të vini në zbatim një ide që e keni lënë mënjanë prej kohësh për shkak të pasigurive. Një takim i papritur do t'ju shtrëngojë që të përballeni me probleme të hershme dhe t'i zgjidhni ato.

**VIRGJERESHA**

Kujdes nga çështjet që kanë të bëjnë me financat, sepse mund të shkaktohen vonesa dhe pengesa në pagesa. Më mirë të merreni vetë me këto gjëra. Shqetësimi në fushën e dashurisë, për shkak të Venusit kundra, mund të bëjë që të merrni vendime gjaknxehta.

**PESHORJA**

Me Hënën që përqafon Plutoni do të ndiheni të sigurt nga një frymë prakticiteti dhe nga largpamësia në investime dhe në projekte. Keni dëshirë të jetoni në thellësi të shpirtit, atë që deri më tani e keni jetuar në nivel të mendjes.

**AKREPI**

Mos i lejoni askujt që t'ju pengojë në realizimin e një projekti që e keni për zemër. Duhet ta mbroni me vendosmëri. Do të ndiheni të mbrojtur dhe të rrethuar nga miq që ju duan dhe ju çmojnë, pa kërkuar asgjë në këmbim.

**SHIGJETARI**

Në dashuri lëreni mënjanë sedrën dhe lojërat e pushtetit. Ecni përpara, kush ju tërheq vëmendjen dhe ju intereson, do t'ju ndryshojë me butësi. Do të keni mosmarrëveshje me njerëz që nuk shkoni mirë, por nuk keni ndërmend të duroni provokimet e tyre.

**BRICJAPI**

Për shkak të Neptunit armiqësor, është e rëndësishme të vlerësoni me qartësi gjendjen ku ndodheni. Mund të ngelni të çuditur, por nuk është koha për zvarritur gjërat. Dashuroni dhe jetoni në mënyrë madhështore, por duhet të mos harroni se jeta ka edhe gjëra të vogla që duhen bërë.

**UJORI**

Me ndikimin pozitiv të Hënës do të keni harmoni në marrëdhëniet familjare. Nëse keni fëmijë apo nipër, do të argëtoheni pa fund duke luajtur me ata. Raporti me partnerin në përgjithësi është i mirë, edhe pse ka pika ku nuk keni mirëkuptim.

**PESHQIT**

Parashikohen ndryshime. Për momentin, mos merrni vendime të prera, që mund të mos jenë më pas të duhurat. Prisni sa të qartësohen gjërat dhe mos bini pre e tundimit për të reaguar menjëherë, sidomos në punë. Rrezikoheni nga shpërqendrimet.

VLERËSIMI




## Strakosha, i pari në Seria A dhe i dyti në Europë

Ngjitja e tij i ngjan një alpinisti në një mal të pjerrët. Është e lodhshme, por tashmë është thuajse e kompletuar. Por flasim për "aplinistin" e Kombëtares sonë, Tomas Strakosha, i cili në vitin 2016 u paraqit në klasën e Lacios, por për të nuk kishte vend. Sot është portieri i dytë në Europë për pritje të bëra gjatë këtij sezoni, në 5 kampionatet kryesore. Ai është i dyti pas Palvlekës së Verder Bremen me 61 pritje, ndërkohë që portieri i Lacialëve ka 58 në një speciale të publikuar nga "Corriere dello Sport". I dyti në Europë, por i pari në Itali. Strakosha në Seria A udhëheq renditjen së bashku me Perin të Xhenoas dhe Nikolas të Veronës. Bie në sy fakti se në renditje ka shumë portierë të skuadrave që mbajnë vendet e fundit në renditje. I tillë është rasti i Verder Bremen, që mban vendin e parafundit në Bundesligë me 16 gola të pësuar. Strakosha këtë sezon me Lacion ka qenë vendimtar, duke bërë disa pritje shpëtimtare, duke e mbajtur skuadrën e Inzagit në vendet e para. Strakosha ka qenë vendimtar edhe të dielën e kaluar me barazimin ndaj Fiorentinës. Mjafton të kujtojmë rastin e Kiezës, i cili u gjend përballë tij, por pa harruar as pritjen e roveshatës së Pezellës. Thomas është gjithmonë aty, për të blinduar portën, për të mbajtur ekipin e tij në avantazh. Është vetëm 22 vjeç, në mars bën 23, por në Itali të gjithë e vlerësojnë shumë, madje ka dhe nga ata që shkojnë deri aty sa e cilësojnë si pasuesin ideal të Buffon. Perla është padyshim pritja e penalltisë së Dibalës, aty ku filloi edhe ngjitja e fundit në 'malin' ku ai tashmë qëndron në krye.


Jeton Selimi

### Drejtori Preiti ka në listë edhe Albi Dokën, por Erioli duket më i arritshëm

# Partizani fiton të parën dhe ëndërron Hoxhallarin

## Të kuqtë thyejnë Pogradecin me golin e Sukajt

Takimi Pogradeci-Partizani ka ulur siparin e ndeshjeve të para të vlefshme për turin e dytë të Kupës së Shqipërisë. Në stadiumin "Gjorgjy Kyçyku" të qytetit liqenor, të kuqtë e Starovës, që shleu me këtë takim dhe dënimin prej dy ndeshjesh nga Komisioni i Disiplinës, kanë fituar minimalisht me rezultatin 1-0 falë golit të vonë të sulmuesit Xhevahir Sukaj. Të kuqtë kishin rreshtuar formacionin e parë për këtë përballje, por shirat e dendur e kishin rënduar terrenin e lojës. 45 minutat e para u mbyllën me shifrat e barabarta 0-0, ndërsa në pjesën e dytë Partizani aktivizon sulmuesin shkodran, nga këmbët e të cilit erdhi dhe goli i fitores në minutën e 85-të të takimit. Me këtë sukses, kryeqytetasit praktikisht hipotekojnë kalimin për në çerekfinale, pasi ndeshja e kthimit mes dy ekipeve do të luhet në Tiranë. Në përfundim të ndeshjes, zëvendëstrajneri Klevis Dalipi deklaroi se të kuqtë tashmë mund të fokusohen lirshëm në kampionat.

**MERKATO**

"Partizanin e vërtetë do ta shihni në janar. Do të afrojmë lojtarë cilësorë", - shprehej Luçiano Moxhi, në TVSH, pas ndeshjes së fituar me Kukësin. Italiani, i cili ka pas vetes trajnerin Sulejman Starova, drejtorin sportiv Antonelo Preiti dhe zyrtarin e kuq, Edmond Haxhija kanë nisur planet e merkatos dhe piketimin e lojtarëve të ndryshëm. Ditën e djeshme, "Eduasportin.com" raportoi se Preiti ishte në stadium për të parë ndeshjen ndërmjet Tiranës dhe Vllaznisë. Synimi ishte i qartë, "demat" duan mbrojtësin e majtë Erion Hoxhallari. 22-vjeçari pëlqehet nga drejtuesit e klubit të kuq, pasi mosha e Kalarit (33 vjeç) të bën të mendosh se do të luajë sezonin e tij të fundit me kryeqytetasit, ndërsa Kotobelli nuk ka përmbushur pritshmëritë e drejtuesve të Partizanit. Në kushte të tilla,



emri i pikasur për krahun e majtë është lojtari i Tiranës. Një tjetër arsye që të bind më shumë është kontrata e futbollistit. Hoxhallari i skadon kontrata me bardheblutë në fund të këtij sezoni dhe "demat" mund ta marrin me kosto zero. Sipas portalit "eduasportin.com", atij do t'i ofrohet një parakontratë që në janar. Mundësia e transferimit të tij në këtë merkato është e vogël, pasi vështirë që presidenti Refik Halili mund ta lërë të lirë, aq më pak te Partizani.

ISH-KAPITENI I ROMËS

## Toti: Pengu im më i madh? Që s'luajta kurrë me Ronaldon

Legjenda dhe ikona e Romës, Françesko Toti, në një intervistë për "Corriere Della Sera", pasi vari këpucët në "gozhdë", foli rreth karrierës së tij me ekipin e jetës, eliminimin e Italisë dhe pengun më të madh si futbollist. "Nuk e imagjinoja kurrë një eliminim të Italisë, do më duket i çuditshëm ky



Botëror pa Italinë", deklaron ish-kapiteni i Romës. Për sa i përket presidentit të ri të federatës, Toti mendon se këtë post duhet ta marrë miku i tij, Damiano Tomasi. Ai foli dhe për pengun e tij të karrierës: "Gjithmonë e kam thënë dhe e përsëris, një nga pengjet më të mëdha të karrierës sime është që nuk luajta me Ronaldo fenomenin. Do të ishte një ëndërr e imja, pasi ai ka shënuar shumë gola, por me siguri me mua do të kishte shënuar më shumë", - ka mbyllur deklaratën e tij Toti. Kujtojmë që kjo ëndërr e Totit do të realizohej pasi në vitin 2003, presidenti i Realit të Madridit, Perez i bëri ofertë për tek "galaktikët", por nuk pranoi, pasi i qëndroi besnik përjetë ekipit të Romës.

SERIE A

## Juventusi shkon i "fashuar" në Napoli

Një dramë që nuk ka fund për Juventusin. Në pritje të duelit të mbrëmjes së nesërme për titull kundër Napolit, trajneri Masimiliano Alegri duhet të bëjë "mrekullira" për të shpikur një formacion të denjë. Sikur të mos mjaftonin të dëmtuarit Marko Pjaca dhe Stefan Lihshtajner, në stërvitjen e fundit janë ndalur edhe mbrojtësi Benedikt Hëvedes dhe sulmuesi Mario Manxukiç, të cilët nuk janë grumbulluar. Kjo bën që Juventusi të ketë probleme të mëdha në ndërtimin e 11-shes titullare. Të gjitha shpresat tashmë varen te Gonzalo Higuain, që ka dhimbje të forta në dorën e operuar, por do të vendoset sot, nëse ai do ta nisë nga minuta e parë, ose jo. Në të kundërt, për herë të parë do të shohim një Juve pa një qendërsulmues në fushë, ndoshta me Dibalën dhe Duglas Kostën në vijën e parë të sulmit. 'Dhimbjet e kokës' së Alegrit bëhen edhe më të mëdha, kur mendon se edhe dy anësorët ofensivë, Huan Kuadrado dhe Federiko Bernardeski kanë kryer vetëm dy seanca stërvitore këtë javë. Prandaj, formacioni anti-Napoli nesër është i gjithi për t'u shpikur.

GJERMANI

## Abrashi rrezikon edhe derbin me… Mavrajn

Frajburgu nuk i kishte shërbimet e Amir Abrashit në ndeshjen e së shtunës me Maincin, pasi mesfushori pësoi një dëmtim javën e shkuar dhe mjekët vendosën të mos rrezikonin me të. U mendua se ai mund t'ia dilte dhe të ishte gati për ndeshjen, por kjo nuk ndodhi. Veç atij takimi, Abrashi mund të humbasë edhe "derbin" me Hambur-



gun e Mërgim Mavrajt. Sikurse raportojnë mediat në Gjermani, mesfushori ka bërë një injeksion dhe ende nuk ka nisur përgatitjet. Një sezon i mbrapshtë për Abrashin, i cili ka luajtur vetëm në tri ndeshje të Bundesligës sivjet. Fitorja e fundit me Maincin ka bërë që Frajburgu të fitojë një vend në renditje, por situata është kritike, pasi janë të 16-tët, me dy pikë më pak se Hamburgu, që është mbi ta me 13 pikë.

SITUATA E RËNDË

## Argjentinë, tifozët masakrojnë gjyqtarin

Një çmenduri e vërtet ka ndodhur në Argjentinë në kampionatin "Federal B", që është dhe liga e katërt në këtë vend. Në ndeshjen çerekfinale mes Juventus de Pergamino dhe Independiente de Chivilcoy, miqtë e mbyllën në avantazh 1-0 pjesën e parë, teksa tifozët e Juventus pushtuan fushën dhe sulmuan arbitrat e ndeshjes. Një foto po bën xhiron e botës, teksa një nga



gjyqtarët duket i mbuluar nga gjaku në banjën e dhomave të zhveshjeve. Sipas mediave argjentinase, arbitri i ndeshjes ishte Bruno Amiconi, ndërkohë që Marcelo Acosta dhe Mauricio Luna ishin asistentët e tij. Të tre janë transportuar në spital, ndërkohë që policia është treguar pasive në veprimet e saj ndaj tifozëve. Një episod i ngjashëm i ka ndodhur dhe klubit të Ayacucho më parë, që i kushtoi edhe rënien nga kategoria.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

